

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545




The **Albanian**

VITI I 20 I BOTIMIT 10 KORRIK 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

**GABIMET E HOME OFFICE, RIKTHEHEN
KËRKESAT PËR SHQIPTARËT!
AVOKATJA BRITANIKE : RITJE
DRAMATIKE TË REFUZIMEVE PËR AZIL**



PETRIT KUÇANA

**PËRSE TIRANA NUK
MERR MODELIN
E KOSOVËS
PËR DIASPORËN?**



ARBEN MANAJ

**“ARMAGEDON”
ELEKTORAL, BRITANIA
“SHKON MAJTAS”:
LABURISTËT NË PUSHTET
PAS 14 VITESH!**


**ZGJEDHJET NË
BRITANI TË MADHE**

DAUT DAUTI



**LETËRSIA E KADRESË ZGJEROI
“MUSHKËRITË” E GJUHËS SHQIPE NË
FRYMËMARRJEN E KOMUNIKIMIT
TONË KULTUROR**

EMIN AZEMI




**EDHE LEJET E
NDËRTIMIT NË DORË
TË RAMËS**

BETI NJUUMA



**ISMAIL KADARE,
DUKE KËRKUAR
NJË VEND KU TA LËSHOJMË**

ARMAND SHKULLAKU



**RIZBULIMI
I KOSOVËS
NË “CAFE LE ROSTAND”**

VETON SURROI



**POROSISNI BANNERIN
PËR BIZNESIN TUAJ**

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website




The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Qeveria e Kosovës ka vendosur tu paguajë emigrantëve që vijnë në Kosovë me automjetet e tyre, policë e sigurimit.

Kjo është një mënyrë jo thjeshtë mirëseardhjeje e diasporës, por shenjë vlerësimi për kontributin e jashtëzakonshëm që diaspora luan në ekonominë e Kosovës dhe jo vetëm. Në kontrast me këtë vendim

të qeverisë së Kosovës nuk ka asnjë lajm nga 'Shqipëria e këtij Drinit', ku termi diasporë nuk është në menynë e propagandës, përveçse ndonjë rast i duhur gjetur shkaqe apo arsye për të mos lejuar shqiptarët me banim jashtë territorit të Shqipërisë të votojnë në zgjedhjet e ardhshme.

Nëse i referohemi ish-ministrit të shtetit për diasporën, se 'gjysma e shqiptarëve jetojnë në diasporë' mbetet tejet e pakuptueshme injorimi që i bëhet diasporës.

Në çdo njësi të qeverisjes vendore në Kosovë organizohen ditët e diasporës, një traditë kjo tashmë shumëvjeçare, por që çuditërisht në asnjë moment kjo nuk u

PËRSE TIRANA NUK MERR MODELIN E KOSOVËS PËR DIASPORËN?



kopjua/zbatua nga institucionet e shtetit shqiptar.

Në Shqipëri nuk ka "Ditët e Diasporës". Institucionet e shtetit shqiptar nuk e kanë parë të arsyeshme, që ti kushtojnë ndonjë kujdes shqiptarëve që jetojnë jashtë, qoftë duke ndjekur modelin e Kosovës apo duke krijuar projekte të angazhimit të diasporës shqiptare. Pas rreth tre

mandatesh në pushtet, qeveria e zotit Rama, nuk e ka vënë ujin në zjarr që të bëjë gjënë më të thjeshtë si regjistrimi i diasporës.

Janë tejet të turpshme shifrat që paraqesin disa nga institucionet për numrin e shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë që janë regjistruar me e-albania. U mendua që

diçka mund të ndryshonte në këtë qasje mbas fjalimit të Athinës apo të Milanos. Në fakt asgjë nuk ndodhi, përveçse anulimit të fjalimit në Londër. Sot e kësaj dite nuk është bërë asnjë transparencë se sa kanë kushtuar këto fjalime dhe mbetet tejet e sigurtë që kurrë nuk do të merren vesh shifrat. Po përse

qeveria shqiptare nuk ka denjuar të adoptojë modelin e Kosovës?

Vini re! Ministria e Jashtme e Kosovës quhet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Qe nga ky element qeveria shqiptare stonon duke shpërfillur të paktën gjysmën e shtetasve të vet dhe as që ve ujin në zjarr për të kuptuar, (së paku për të kuptuar) se vetëm shqiptarët e Shqipërisë janë të vetmit në rajon dhe më gjerë që nuk e kanë të drejtën e votës, një njollë turpi për një qeveri që ka më shumë se një dekadë në pushtet. E pikërisht këtu duket se janë edhe arsyet e injorimit total të diasporës.

Vetëm imagjioni nëqoftëse do të votonte diaspora, a do të kushte qeveria këtë qëndrim. Krejtësisht e kotë do të duket ngritja e pyetjes; deri kur?

AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARËT NË UK

HA Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road. Hounslow, London. TW3 1PA

IMPERIUM CHAMBERS

(ZYRE LIGJORE ME BARISTER TE KUALIFIKUAR PREJ 25-VITESH)

A JENI KONFUZ NGA
NDRYSHIMET E SHUMTA
LIGJORE TE EMIGRACIONIT DHE
KENI NEVOJE PER NDIHME DHE
QARTESI?!

-NUK JENI
VETEMI!

Tel 1: 07901181592

Tel 2: 02072423488

Address: Thanet House, 231-232
Strand, Temple, London,
WC2R 1DA

NE JEMI TE SPECIALIZUAR NE CDO FUSHE TE EMIGRACIONIT

DHE OFROJME NDIHME ME GJITHCKA PERFSHIRE:

Refuzimin e azilit pa te drejte gjyqi
Aplikime/ri-aplikime nga e para
Apelime ne te gjitha gjykatat
Bashkime familjare ose visite ne uk



TELEFONONI **ADELEN** NE **07901181592** PER T'U KONSULTUAR



Keni nje Bizness qe po rritet?

**DONI TE MERNI PUNETOR NGA SHQIPERIA NE
ANGLI?**

TE SPECIALIZUAR NE

BUSSINESS IMMIGRATION
OFROJME APLIKIM TE SIGURTE PER
SPONSORSHIP LICENSE

Bizneset perfshijne:


Kompani ndertimi
Restorante/café
Car washes

Care homes
Office work
Berber

***DHE SHUME BIZNESE TE TJERA**

SHERBIMET QE OFROJME:

- Human Rights
- Judicial Review
- Appeals
- Fresh Claims
- Asylum
- Overstayers
- Stateless
- Detention and Bail
- EEA Family Permit
- ILR/Natyratisation
- Change of Nationality from Kosovan to Albanian
- Work and Student Visa
- Spouse Visa
- Visitor Visa
- Divorce



Email:
adela.bushi@imperiumchambers.co.uk
enquiries@imperiumchambers.co.uk
Website:
www.imperiumchambers.co.uk
YouTube:
The Immigration Barrister



ARBEN MANAJ

Ka qenë media britanike që raporton se janë me mijëra raste kërkesash për azil, që ish-Kryeministri Rishi Sunak pretendonte se ishin shqyrtuar dhe mbyllur si çështje, të cilat do rikthen për shqyrtim në Home Office, për shkak të shtimit të rasteve të apelimeve, të cilat fajëson ngutjen në procesin e vendimmarrjeve.

Sipas The Guardian të Londrës, sfidat ligjore kundër më shumë se 29 mijë vendimeve të marra në periudhën 2022-2023, ç'ka është katër herë më shumë se një vit më

parë, ka çuar në mbingarkesë të gjykatave speciale, që shqyrtojnë këto raste apelimi.

Zyrtarë të Home Office citohen të kenë thënë se punonjësit e shërbimit civil do duhet të të rishqyrtojnë nga e para raste që janë refuzuar apo tërhequr gjatë nxitimit për të përmbushur premtimin e ish-kryeministri Sunak, për pakësimin e stivës së dosjeve të pashqyrtuara të azilit me 90 mijë syresh, deri në fund të 2023.

Mes këtyre rasteve të mbyllura ka edhe shumë kërkesa për azil, të bëra nga shqiptarë. Sipas Esme Madill, avokate që punon në një projekt të specializuar vetëm për mbrojtjen e azilantëve

GABIMET E HOME OFFICE, RIKTHEHEN KËRKESAT PËR SHQIPTARËT! AVOKATJA BRITANIKE : RRRITJE DRAMATIKE TË REFUZIMEVE PËR AZIL



të rinj shqiptarë, dhe e sapo zgjidhur si avokatja me e mirë e vitit në Britani, thotë për Top-Channel se

po shohim shumë vendime të jashtëligjshme nga azilkerkues shqiptarë dhe po i sfidojmë ato

nëpër tribunale e apelit.

“Ka pasur një rritje dramatike në refuzimin e kërkesave për azil nga shqiptarët dhe ne po sfidojmë me sukses këto refuzime përmes rishikimeve juridike dhe ka një fakt që flet shumë se rastet e apelimeve të suksesshme janë mbi 50 përqind të rasteve të apeluara në gjykata, edhe pse ka pasur një rritje dramatike të rasteve të refuzuara nga Home Office.

Kjo tregon se shumë nga këto vendime janë të jashtëligjshme”, tha Esme Madill, avokate emigracioni në Londër.

Mbetet të shihet se cila do jetë qasja e qeverisë së re britanike të kryeministrit laburist Sir Keir Starmer, ndaj çështjes së azilit dhe emigracionit, dhe a do të ketë sukses apo do dështojë edhe kjo qeveri, si paraardhësit e saj.

HA
HARIS ALI SOLICITORS

KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk



Për shitje

Mob:
07939484609

Mbi 15 vite Lease


**I pajisur me te gjitha
licensat**

**Lokali eshte i hapur
prej vitesh me klientele
te garantuar**

**Mundesesi fantastike
per zgjerimin e biznesit**

**Çmimi teper i favorshem
Per me shume info
na kontaktoni
Mob:
07939484609**

Një ndër lokalet më të frekuentuara në Walthamstow



ARBEN MANAJ

“ARMAGEDON” ELEKTORAL, BRITANIA “SHKON MAJTAS”: LABURISTËT NË PUSHTET PAS 14 VITESH!

Laburistet e opozites se qendres se majte, nga sot e tutje do jene administratoret politike te fateve te Britanise, pas nje armagedoni elektoral qe dergon ne opozite konservatoret e partine me te vjeter ne Britani.

Kjo i ka shkaktuar atyre humbjen me te madhe ne dy shekujt e fundit, nderkohe laburistet arrine nje fitore perafersisht te ngjashme me ate te Toni Blerit ne 1997.

Per here te pare babai i Brexit Nigel Farage do jete deputet bashke me tre kolege te tij nga partia Reforma, nderkohe laburistet kane humbur disa vende perballe kandidateve te pavarur nga komuniteti myslyman per shkak te konfliktit ne Gaza.

Kryeministri i ri, Sir Keir Starmer, do jete kryeministri i shtate ne historine e politikës britanike dhe ndodhet perballe nje grope te madhe financiare te shkaktuar nga keqadministrimi i konservatoreve. Britania votoj majtas nderkohe qe shume demokraci perendimore, kane zgjedhur dhe tentojne te zgjedhin forca politike te djathta.

Nderkohe kandidatja shqiptare Sara Gezdari, e bija ish-futbollistit te njohur Mond Gezdari, ne rrjedhet e konservayoreve ka humbur sic pritej ne zonen me te pasur te Londres, me shume per faj te parties qe aderon ku edhe Sunak po te konkuronte do mund te humbiste. Ish kryeministri Rishi Sunak, e filloj fushaten dhe shpalljen e dites se zgjedhjeve ne 22 Maj me shi, dhe largohet me humbje ne nje dite me shi sot ketu ne Londer.

Ashtu si vepron natyra, pas shiut del dielli dhe anasjelltas dhe e tille eshte edhe natyra e politikës dhe demokracise. Tani fillon ndryshimi, thote kryemisniri ri laburist, Sir Keir



Stamer, por asgje nuk do ndryshoj brenda nates dhe sfidat per qeverine e tij te pakten nuk do jene ne parlament, ku ai ka nje shumice dermuese. sesa ne qeverisje e perditshme te puneve dhe aspiratave te britanikeve qe i besuan atij dhe parties se tij permes meteorit elektoral qe goditi politikisht ishullin.

Sfidat e Laburistëve, janë kundër rrymës, partnerët e tyre strategjikë po ecin djathtas

Fillimi i ri per Britanine pas meteorit elektoral, e gjen Britanine perpara nje bote e cila eshte duke u kthyer me kokeposhte c'ka paraqesin sfida per

qeverine e re laburiste te Sir Keir Stamer.

Kjo pasi partneret e Britanise po ecin djathtas pikerisht ne drejtim te kunder me ate te pushtetit ne Britani, permes ardhjes ne Doëning Street, te te majteve me nje shumice te frikshme, e cila ofron nje te ardhme realtivisht te qendrueshme, edhe pse aspak intriguese.

Por nese kjo vlen per Britanine kjo nuk mund te thuhet per partneret e saj duke filluar nga Franca ku sundimi i qendres duket se po merr fund, apo Gjermania e cila po kerrenohent nga ekstremi i djathte, por me shume nga ekonomia e saj dhe rekrusionet e krizes franceze kur vjen puna tek projekti evropian kur dihet se Franca dhe Gjermania jane dy motoret binjak te

ketij projekti.

Nderkohe pertej Atlantikut nje mandat i dyte i Trumpit kercon trazira ne skenen nderkombetare me renien potencialisht terminale te Nato-s dhe pranimin e fitoreve te agresionit rus ne Ukraine, nese Tramp fiton. Sakaq ne planin e brendshem Tramp flet per shpagim, cka nenkupton trazira e perplasje.

Kjo nuk eshte hera e pare qe Britania gjendet ne kohe vorbullash dhe trazirash te tilla diplomatike dhe nderkombetare, dhe pavaresisht se kush fitoi ne zgjedhjet e fundit, egziton nje ndejne katarsisi dhe lehtesimi se sistemi politik britanik ende qendron ne kembe dhe i palekundur, pas nje periudhave me te trazuar ne his-

torine e ishullit.

Shume nga kolonat e politikës ne jashtme britanike nuk do ndryshojne, por duket se marredheniet me Evropën pritet te forcohen me shume, dhe korrigjohen disa nga defektet e Brex-it, nderkohe vemendje priret dhe duket se do i kushtohet me shume vendeve te Lindjes se Larget te cilat jane neglizhuar deri diku nga ish-qeverite konservatore te largura me vote kete jave.

Fakti qe Britania do notoje kunder rrymes ne nje bote gjithnje e me diverse, lipset te jete me me kembe ne toke dhe adoptoje qasjen e “realizmit progresive”, dhe kjo menjehere dhe pa humbur kohe, duke nisur nga ngjarjet e kesaj fundjave ne France.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946

DAUT DAUTI

ZGJEDHJET NË BRITANI TË MADHE

Konzervativët kanë pësuar humbjen e tyre më të madhe në historinë e zgjedhjeve në Britaninë e Madhe. Arsyeja e këtij debakli politik në sfond e ka Brexitin.

Me Brexit konzervativët premtuan ndaljen e emigracionit dhe përmirësimin e ekonomisë. Asnjëra nuk ka ndodhur. Ardhja e emigrantëve është trefishuar kurse ekonomia është në nivelin e zhvillimit të premtuar. Në politikën e jashtme qeveria e Sunakut e ka mbrojtur pa rezerva Izraelin në luftë kundër Gazës dhe kjo është një shtesë tjerë që i është kthyer si hakmarrje.

Kier Starmer me laburistët është kthyer në pushtet me fitore të thellë sikur Tony Blairi në vitin 1997. Megjithatë këto dy kthime shënohen me dallime serioze. Për laburistët e Blairit numri i votuesve ka qenë diku rreth 4 milionë më i lartë se sa është kjo sot për laburistët e Starmerit. Toni Blair që pritur në funksion me një entuziazëm të madh popullor dhe ndryshimet që solli në politikën e jashtme dhe të brendshme britanike, janë historike.

Starmer as përafërsisht nuk e ka



fuqinë e as karizmën e Toni Blairit. Llogaritet se laburistët në këto zgjedhje fituan më shumë për shkak të iritimit dhe zhgënjimit të votuesve me

dështimin e konzervativëve që krijuan destabilizim në politikë. Në fakt laburistët e sotëm nuk dallohen shumë, apo si më parë që janë dalluar

me konzervativët.

Një karakteristikë tjetër është rritja e numrit të deputetëve të "Reform UK",

parti që konsiderohet si e djathtë ekstreme e që udhëhiqet nga Nigel Farage, aktivisti dhe propaganduesi kryesor i Brexitit.

Numri i deputetëve nuk është ende definitiv, por duket që kjo parti nuk ka fituar më shumë se 5 vende në parlament, se bashku me Faragein. Megjithatë, numri i deputetëve që kanë pikëpamje të ngjashme me këtë parti minore është prezent në partinë konzervative, por edhe në ate laburiste.

Pra, ekstremi i djathtë është në shtim e sipër edhe në Britani, por as përfërsisht sikur në Francë, Holandë dhe vende tjera evropiane.

Një gjë e mirë është se politika e qeverisë së re laburiste nuk ka dhënë shenja se do të shënojë ndonjë ndryshim ndaj Kosovës dhe Ballkanit.

Një lajm tjetër i mirë brenda konzervativëve është fitorja e Alicia Kearns, e cila me funksionin e saj të rëndësishëm ka shprehur qëndrim të drejtë për Kosovën.



You're better
off with
Specsavers
this summer

2 for 1 from £70

With single-vision lenses to the same prescription

Specsavers

ARTE Home Furniture

NOW OPEN




%20

WITH THIS
VOUCHER



Address: 1 Aldermans Hill, London N13 4YE

0 7447 992436

 [artehomefurniture](#)

 [artehomefurniture](#)

 info@artehomefurniture.co.uk

ARBEN MANAJ

Ish-Sekretari i Pergjithshem i Natos, Lordi Robertson dhe lektori me origjine shqiptare ne University College ne Londer Andi Hoxhaj, i nderuar me titull kalorsiak nga Mbreti Charls i Anglise, para pak kohesh, theksojne se Nato duhet te luftoje destabilitetin ne Ballkan, dhe paralajmerojne per rreziqet nga Rusia dhe Kina per gadishull, Ballkanin, ne esene e tyre te botuara ne edicionin e fundit te The Economist.

Natoja, udheheqesit e te cilit mblidhen te marten ne Uashington per 75 vjetorin e Aleances, mes shume sfidave si Ukraina e konfliktet e tjera apo rreze te grumbulluara nga skepticizmi trampian, argumentojne se Ballkani do jete vatra e ardhshme e konfliktit dhe aleanca duhet te adresojte perkeqesimin e situates ne gadishull, u cili ka perjetuar rritje tensioni nga perplasjet etnike pas pushimit te Ukraines.

Lordi Roberston dhe akademiku Hoxhaj i referohen paralajmërimit ne Tirane te Presidentit ukrainas Zelenski ne shkurt, kur ne Shqiperi deklaroi se "Rusia do beje gjithshka per te destabilizuar situaten". Sipat tyre, NATO dhe BE-ja, nuk po marrin seriozisht influencen e Rusise dhe aktivitetin e saj, as implikimet e perfshirjes dhe penetrimit te Kines ne Ballkanin Perendimor.

BE dhe Amerika deri diku kane

toleruar lidhjet akoma me te ngushta te Serbise se Vucicit me Rusine dhe Kinen. Kjo ka bere qe Serbia te

"DESTABILITET NË BALLKAN!" PARALAJMËRIMI I "THE ECONOMIST" NJË DITË PARA SAMITIT TË NATO-S NË UASHINGTON



trimerohet ne perpjekjet per minimin e shtetformimit te Kosoves. Artikujshkruesit kerkojne shtimin e presionit ndaj Presidentit Vucic.

Ata sugjerojne se BE do duhet te pranoje se Nato nuk mund ta mbaje e vetme te qendrueshme situaten ne Ballkanin Perendimor dhe do duhet t'u ofroj te gjitha vendeve te Ballkanit Perendimor nje perspektive realiste per anetaresimin ne BE.

Te vetedijshme per ndryshimet potenciale ne administraten amerikane pas zgjedhjeve te ardhshme presidenciale, ne prag te samitit me rastin e 75 vjetorit te Nato-s, ish shefi i saj Lordi Robertson dhe lektori Hoxhaj nga University College ne Londer, paralajmerojne ne esen e botuar ne The Economist, pasi me pare te dy kishin deshmuar perpara Parlamentit britanik, se bota po behet gjithnje e me e frakturuar.

Sipas tyre riafirmimi i unitetit dhe perbashkimi i qellimeve te BE dhe Nato-s ne Ballkanin Perendimor eshte kesoj kritik per shmangjen e mundesise se rindezjes se konfliktit ne nje pjese mjaft te pa-parashikueshme te Evropes.

MONITOR

EMIGRACIONI PËRKEQËSON STRUKTURËN E FAMILJES, RRITEN ME 152% ÇIFTET PA FËMIJË

Popullsia e Shqipërisë rezultoi më e pakët dhe më e plakur në Censin e vitit 2023, por gjithashtu struktura e familjeve shqiptare është përkeqësuar ndjeshëm si rezultat i rënies së lindjeve dhe emigracionit. Censi gjeti një fenomen të cilin e kishin lajmëruar më parë. Në totalin e familjeve shqiptare, pati një përqindje të madhe të njëjësive të familjeve pa fëmijë, të cilat janë rritur ndjeshëm në krahasim me vitin 2011.

Sipas të dhënave të Cens 2023, familjet e martuara ose që bashkëjetojnë pa fëmijë ishin 264,882, me rritje 152% nga Censi 2011. Numri i familjeve ndërmjet dy censeve u rrit me rreth 33 mijë ose 4.5%, por numri i çifteve pa fëmijë ka shënuar rritje të ndjeshme për shkak të emigracionit të lartë të rinjve gjatë dekadës së fundit.

Gjithashtu, çiftet e martuara ose në bashkëjetesë gjithnjë e më shumë po e shtojnë lindjen e fëmijës së parë. Shumë nga çiftet e reja marrohen dhe nisin përgatitjet për të emigruar duke vonuar ardhjen në jetë të bebeve.

Sipas censit, bërthamat familjare më të shpeshta përbëheshin nga çifte të martuara ose bashkëjetues me fëmijë, 52,2%, e ndjekur nga çifte të martuara



ose bashkëjetues pa fëmijë, 37,5%, ndërsa prindërit e vetëm me fëmijë

përbënin vetëm 10,3% të tyre. Emigracioni i dekadës së fundit uli nd-

jeshëm edhe numrin e anëtarëve të familjes. Në censin 2023, madhësia

mesatare e familjeve është 3,2 anëtarë, krahasuar me 3,9 anëtarë për familje në Censin e 2011 dhe 4,2 anëtarë në vitin 2001.

Në vitin 2023, rreth një në katër familje, 24,3% kanë si person reference grua, personi i cili përgjithësisht merr vendimet kryesore dhe njihet si i tillë nga të gjithë anëtarët e saj. Në censin e vitit 2001, familja në përgjithësi në Shqipëri karakterizohej nga një numër i madh anëtarësh, mesatarisht 4.2 anëtarë, që përbënin 2/3 e 727 mijë familjeve me katër apo më shumë anëtarë dhe një e katërta e përqendruar në madhësinë prej 4 anëtarësh.

Ndërsa në vitin 2023, rreth 28,5% e familjeve, përfaqësohet nga tipologjia me përbërje prej dy anëtarësh, e cila është dhe kategoria më e madhe. Familjet më të mëdha, me pesë apo më shumë anëtarë, përfaqësojnë më pak se një të pestën (19,5%) të familjeve, e njehsuar me një të tretën e popullsisë (35,8%)./ Monitor

ARMAND SHKULLAKU

Shteti shqiptar dëshmoi edhe njëherë se është i paafte, qoftë edhe për t'i gjetur një vend prehje të denjë një personaliteti të shquar që i kalon përmasat kombëtare. Ndarja nga jeta e shkrimtarit të madh, Ismail Kadare, kapi në flagrancën e joseriozitetit një shtet të tërë, që në mbi një shekull ekzistencë, nuk ka bërë vend për të nderuar pas vdekjes figurat e shquara të tij.

Kaosi që shkaktoi vdekja e paparalajmëruar e Kadaresë, përshkoi fjalimin e lamtumirës së kryeministrit shqiptar, i cili më shumë se një homazh për shkrimtarin, tingëlloi si një rrëfim për hallin e tij se ku duhej t'i gjente një vend që t'i shkonte për shtat përmasave të pavdeksisë së Ismailit. Dhe lamtumira e fundit, nga një moment solemn për Kadarenë, u shndërrua në odisenë plot andrralla të kryeministrit, që ende nuk po gjente një varr që atij t'i dukej i përshatshëm për të nderuar shkrimtarin.

Ashtu si në poezinë "Kristal" të Ismailit, "...tani kërkoj unë poshtë e lart, një vend ku ty të të lëshoj...", shqiptarët dëgjuan në takimin e fundit të tyre me shkrimtarin, se si ai nuk mund të prehej në Varrezat e Dëshmorëve, por as pranë vëllezërve Frashëri e aq më pak në lulishtet e vetme që kanë mbetur, përballë hotel Rogner apo pas kryeministrit. Për të gjitha këto propozime, kryeministri kishte refuzuar duke interpretuar sipas mend-



jes së tij çka do të kishte dashur vetë Ismaili. Te dëshmorët jo, se Ismaili nuk kishte rënë dëshmor dhe as kishte patur dëshirë të martirizohej. Te vëllezërit Frashëri jo, se s'kishte shumë vend mes tyre dhe do i trazohesh vetmia e përjetshme. Një lulishtet jo se jo, se të vdekurit duhet të ndahen nga të gjallët aq më shumë që, sipas Ramës, Ismaili u ikte vendeve

ku grumbulloheshin njerëz. Sigurisht që këto interpretime, për hallin e një shteti që nuk di se ku t'i bëjë vend një personaliteti, Ismaili vetë nuk kishte mundësi t'i konfirmonte.

E kështu, në pritje që të gjendet, të ngrihet apo të sajohet "panteoni ynë", si për shumë gjëra në Shqipëri, erdhi

në ndihmë "leja" provizore e një vend- prehje në varrezat e Tufinës. Për një afat ende të pacaktuar, derisa të dizajnohet, normalisht nga një studio me repute ndërkombëtare, "godina" e atyre që do të meritojnë të banojnë pas vdekjes. Ateherë me siguri do të kemi një tjetër ceremoni: inaugurimi, zhvarrimi e rivarrimi dhe një tjetër fjalim mbi shkrimtarin dhe din-

jitetin e shtetit shqiptar.

Nëse do ta kishte ditur andrallën që shkaktoi me ikjen e tij, shkrimtarit, që në fiksonet e tij u end aq shumë mes të gjallëve e të vdekurve, mes fantazmave e varreve, do t'i mbetej peng historia e parrëfyer trupit të tij, që tashmë është i destinuar të ndërrojë vend të paktën dy herë. Ai do të ketë një vend- pushim provizor në Tufinë, për të udhëtuar më pas, nuk dihet se kur dhe ku, në një tjetër destinacion që do të cilësohet i denjë nga kryeministri.

Njeriu që në të gjallë nuk ia dorëzoi asnjë pushteti lirinë e mendjes, tani është i pamundur të vendosë për fatin e trupit të tij. Duke materializuar kështu për së vdekuri, marrëzinë shqiptare që e magjepste për së gjalli. Vdekja e shkrimtarit që kap të papërgatitur një shtet, dilemat dhe mbledhjet e gjata, propozimet dhe çpropozimet, netët pa gjumë të kryeministrit, debatet deri në të gdhirë, për të "kërkuar një vend ku ta lëshojnë", do të ishin ndoshta romani i fundit i Ismailit. Të cilin ai nuk mund ta shkruante, por na bëri të gjithëve ta lexojmë. ©lapsi.al

BETI NJUMA

EDHE LEJET E NDËRTIMIT NË DORË TË RAMËS

Sot, në një ditë përvëluese blackout-i ku sytë dhe mendja rendin pas një topi, kanë hyrë në fuqi ndryshimet e fundit të VKM NR.408, DATË 13.5.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT".

Është vendimi që vret përfundimisht bashkitë e vendit, vendimarrjen dhe autonominë lokale dhe vizionin e të zgjedhurve lokalë. Është vendimi që gjithashtu do të vrasë arkitektët dhe të gjithë brezat e rinj të projektuesve që do të dalin nga universitetet.

Nga sot, me ndryshimet e VKM 408, në Nenin 19 "Lejet e ndërtimit për të cilat është përgjegjëse KKTU-ja":

– shkronjës "ë" të pikës 1, pra kompetencave të KKTU për miratim të lejeve i shtohen përveç të tjerave dhe objektet si më poshtë:

"komplekse ndërtimi multifunksionale, komplekse turistike, mbi 5000 m³".

Kjo është ULËRITËSE. Pra të gjitha bashkitë nga sot e tutje do të japin leje ndërtimi VETËM për objekte deri në 5000 m³ aq sa është afësisht, një pallat me 5 kate dhe njollë ndërtimi 300 m². Më saktësisht, thajse aq sa pal-latet 5 katëshe të ndërtuara para viteve

90-të.

Me këtë ndryshim lejet më të mëdha se ky volum do të përqendrohen vetëm në duart e një njeriu, kryeministrit Edi Rama Pra, kryeministri ynë, përveç politikës, impenjimeve ndërkombëtare, pikturës, skulpturës e podkasteve i ka hapur vetes edhe një front të ri pune, atë të shqyrtuesit dhe miratuesit të çdo projekti arkitekturor në vend më të madh se një pallat 5 katësh, duke lënë me gisht në gojë 61 bashkitë në vend!

Nga sot, kryetarët e bashkive nuk do të kenë më asnjë kompetencë për leje ndërtimi të rëndësishme. Bashkitë shndërrohen kështu vetëm në institucione taksambledhëse që do të japin leje të kategorisë së tretë, për magazina dhe shtesa kati.

Ku shkoi autonomia vendore? Po vizionet e Bashkive për zhvillimet e qyteteve ku janë votuar? Me keto ndryshime punën e 61 bashkive tani do ta bëjë AZHT-ja dhe KKTU-ja. Që do të thotë se do të duhen qindra punonjës staf i kualifikuar, jo partiak, që të bëjnë punën e zyrtarëve aktualë



të bashkive.

Paradoksalisht, tani që administratës bashkiake i zvogëlohet puna dhe kompetencat qeveria po i rri pagat duke i unifikuar, nga Vermoshi në Konispol.

As më shumë e as më pak DIKTATURË!

Se dyti, falë ndryshimeve të reja, që hynë sot në fuqi, vendimi tjetër që na kthen në komunizëm është ndërtimi i banesave TIP në zonat rurale. "Pro-

jekt TIP" quhen projektet e hartuara dhe miratuara nga autoriteti vendor përkatës për qëllime strehimi dhe banimi në zonat rurale, në përputhje me dokumentet e planifikimit në fuqi." Me këtë nen, i shkelet e drejta e çdo individi që jeton në zona rurale, të ketë shtëpinë që ai do, natyrisht duke zbatuar ligjin. Nga ana tjetër, ky vendim, nxjerr jashtë loje shumë arkitektë të vjeter e të rinj, të cilëve u mohohet e drejta e ushtrimit të profesionit privatist. Është jashtë çdo logjike që në vitin 2024 me paratë e tua dhe në tokën tënde, (pasi këto nuk janë banesa sociale që t'i fal shteti) të ndertosh një objekt të projektuar për të gjithë njësoj. Luftë klasash në demokraci.

Pasi i rriti tatimin profesioneve të lira, përfshirë këtu edhe të arkitektëve, tani qeveria po i lë pa punë, ndërsa projektuesit presin prej vitesh lehtësimin e procedurave dhe afateve të dhënies se lejeve të ndërtimit, heqjen e sekserave dhe korrupsionit.

Ajo që e bën edhe më të dhimbshme

këtë VKM, është se ndryshimet vrastare kaluan në heshtje pa opionencën e askujt. Heshtën kryetarët e bashkive duke u nënshtruar në mënyrën më amatore të mundshme. Nuk reagan as kryetarët e bashkive të opozitës. Nëse kanë qenë të informuar atëherë kjo është paafte. Nëse nuk kanë qenë të informuar, atëherë kjo është e jashtëligjshme dhe abuzive. Po ashtu heshtën grupet e interesit, arkitektët dhe urbanistët të cilët në të gjitha vendet normale, thirren për të mbrojtur dhe projektuar të ardhmen. Në Shqipëri, këto kategori ose nuk janë të interesuara ta ndihmojnë këtë vend që po shkon drejt shkatërrimit në shumë fusha ose rreshtohen me kokën lart e pa ju skuqur faqja në krah të pushtetit. E nuk kishte si të ndodhte ndryshe edhe në këtë rast!

Heshtën specialistët e fushës, pedagogët e arkitekturës dhe shoqata inekzistente e arkitektëve. Ata që duhet të ishin të parët, që të ngrinin zërin, të bënin opionencë dhe të informonin opinionin publik duke harruar se janë të parët që e pësojnë nga kjo VKM e radhës./ Marrë nga Facebook i autorit, titulli origjinal "QEVERIA EKZEKUTON BASHKITË"

ANDI BEJTJA

Teksa sot në mëngjes po hyja në kafën pranë shtëpisë së mamasë për të pirë kafën e përjavshme me të, në televizion po shfaqeshin pamje nga homazhet e shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare.

Sapo kishte mbaruar dhe fjalimi i Ramës (të cilin e dëgjova më vonë). Ndërkohë si ndodh rëndom në të tilla raste nuk shpëton pa u ngacmuar nga dikush, por këtë herë ngacmimi qe tejet i vecantë...

Një i moshuar me paterica në dalje e sipër mu afrua pa teklif duke mu shtrirë gati në tavolinë: Analist tha, ore me kë je sot në këtë debatin ku ta varrosim Kadarenë, me variantin e Feivziut apo të Ramës. Ngrita supet shumë i çuditur dhe iu përgjigja i shtangur: nuk e di se nuk e kam dëgjuar akoma çfarë ka thënë Rama. Ndërkohë më parakaloi grafikisht propozimi i Fevziut për ta varrosur tek vëllezërit Frashëri, i publikuar dhe në faqen e Klan, madje diku kisha parë dhe një sondazh online a jeni dakort me propozimin e Feivziut....

E pashë dhe e ripashë fjalimin e Ramës në ditën e fundit në këtë botë, jo thjesht si gazetar, po më shumë si qytetar i Republikës së Shqipërisë dhe si admirues i një pjese të veprës së tij dhe u ndjeva i përdhunuar.

KONCERT NË VITIN 2024



Asnjë fjalë për veprën, jetën, shumë pak fjalë për familjen dhe dhimbjen e saj siç ndodh rëndom në këto raste, por kryekëput polemikë me Feivziun e çdo propozues në rrjete sociale për vendin ku do e varrosin. Për më tepër gjatë gjithë ceremonisë që Rama tha se e kishte kuruar vetë me detaje nuk foli asnjë familjar, asnjë shkrimtar,

asnjë nga miqtë e tij të ngushtë e të vërtetë në vite, asnjë zyrtar nga Kosova, të cilën Kadare e ka përfaqësuar po aq sa dhe Shqipërinë: fare e pazakontë, jo njerëzore, aspak protokollare, veç nëse kjo ka qenë dëshirë e familjes që të fliste vetëm Rama mund të gjejë justifikim.

Si zakonisht aty ku ka dorë Rama dhe fasada nuk mungon, sidomos për

ndërkombëtarët. Dekori i lenë enkas i Nënë Terezës dhe simbolet e Kryqit, ngjanin më shumë si një gomë e madhe që përpiqet të fshijë më kot emrin me origjinë myslimane Ismail. Mos u lodh kot Fevzi! Kadare nuk do varrosset ku do ti, as edhe ndonjë tjetër që çirret në TikTok, rrezik as ku do dhe vetë familja.

Mjafton të kujtosh vonesat e bluzave të kombëtares që prisnin dizajnmin nga Rama. Mjafton të kujtosh si hipi vetë në autobusin e lojtarëve të kombëtares në 2016, ose kujto si leu vetë godinat e Klanit edhe pse Sandri ia la enkas me vullnet të plotë ta bënte, për të kuptuar edhe njëherë që dhe estetikisht, dhe kur nderojmë dikë dhe kur varrosim dikë me vlera, çmendurisht na i përcakton rregullat jo protokollit, jo njerëzoria por Edokracia.

Nga fjalimi i Ramës, kuptohet fare qartë që shkrimtari Ismail Kadare do të varrosset përkohësisht në Tufin për t'u zhvarrosur prapë derisa Rama të flasë me arkitektin e zemrës për të bërë ndonjë muzeolum a panteon në një vend ku nuk i shkon mendja as Feivziut as Familjes, duke ia vënë vetë epitafin dhe ndoshta duke tranferuar disa nga fluturat që ka në muret e Kryeministrisë.

Jam i sigurtë që mund të jetë madhëtor, i bukur apo në daçi dhe i përkorë...Do i pëlqejë shumë vizitorëve sidomos atyre të huaj, estetikisht mund dhe mos kemi ç'të themi, por në thelb e gjitha kjo është një festë primitive fshati që nuk ka të bëjë me njerezoren e me civilizimin dhe mbi të gjitha me respektin e dinjitetin e atij që po na thotë lamtumirë pas jo pak punërave të lavdërueshme.

Tani që po i shkruaj këto radhë më vjen ndërmend kur Presidenti Francez kërkoi ta varrosset shkrimtarin Albert Camus në Panteon dhe familja i tha jo.

Shkurt dhe si përfundim ia morën Kadaresë dhe ditën e fundit, siç ia morën në fakt dhe statusin pro marëveshjes së refugjatëve me Melonin apo qoftë dhe letrën drejtuar Lulzim Bashës në 2011 (kandidat për bashkinë Tiranë), apo edhe shumë "heshtje" kur si intelektual i përmasave të mëdha dhe mund të fliste. Ndoshta shqiptarët do ta kishin respektuar më shumë Kadarenë po ta kishin përcjellë për në banesën e fundit në Prishtinë! Unë personalisht e kam bindje. E paça gabim.

SADIK ELSHANI

AS PËR LOTIN E NJË FËMIJE...

Është për t'u habitur e duket si diçka e pakuptimtë kur lexon e dëgjon se një pjesë e mirë e shqiptarëve ende flasin me adhurim për regjimin komunist. Habia është edhe më e madhe kur e dëgjon këtë edhe pas më shumë se 30 viteve nga rënja e komunizmit në Shqipëri. E dëgjon këtë edhe nga një pjesës e mirë e shqiptarëve që me vite të tëra jetojnë në ShBA dhe vende të tjera përendimore, të cilët e shohin me sytë e tyre sesi funksionojnë shoqëritë demokratike dhe vlerat njerëzore që ato i rrezojnë. Jetojnë në këto vende dhe i gëzojnë privilegjet që këto vende i ofrojnë, por ata mendjen dhe zemrën e kanë te një periudhë e errët e historisë së kombit tonë – periudhës komuniste. Munden ta arsyetojnë përkrahjen e tyre për regjimin komunist duke i radhitur disa të arritura: ndërtimi i hidrocentraleve, ndërtimi i hekurudhave, shëndetësia, arsimit, etj. Wshtë e kuptueshme që kur një regjim rri në pushtet për afro 50 vite diçka duhet të ndërtohet, se ndryshe nuk mund të ekzistonte. Në rastin e Shqipërisë shumica e ndërtimeve janë bërë me ndihmën e Jugosllavisë në fillim e pastaj me ndihmën e Bashkimit Sovjetik e Kinës. Kur u prishën këto marrëdhënie, që më mirë mos të kishin ekzistuar fare, regjimi komunist nuk mund t'i përballonte sfidat e shumta ekonomike dhe ai regjim u shemb, falimento. Edhe nëse është bërë ndonjë gjë e mirë, është bërë duke e paguar një çmim të madh: zhdukjen e lirisë së njeriut, eliminimin e elitës intelektuale, arrestimet, burgosjet, internimet, pushkatimet që nuk u ndalen kurrë deri në grahamat e fundit të atij

regjimi çnjerëzor. Regjim që u fundos nga pesha e rëndë e krimt, paafetësisë, injorancës – regjim që u mposhtë nga populli më i molisur i kontinentit evropian. Një e keqe i hijëson, i mbulon të gjitha të mirat, e në Shqipëri në atë kohë kanë ndodhur shumë të këqia. Nga të mirat nuk përmbysen asnjë regjim. Nëse qenka jetuar mirë në atë regjim, atëherë përse shqiptarët e shporrën atë?! Wshtë shkruar mjaft për atë periudhë dhe këtu nuk do të ndalemi më tepër, janë dokumentuar mirë çmenduritë e asaj kohe. Zbehtësinë e këtyre "përparimeve" bukur e ka paraqitur Visar Zhiti në romanin e tij, "Këpuca e aktorit" (Tiranë, 2022, f. 130): "Me fitoren e tyre, vërtet punojnë të gjithë, mbase edhe bukë kanë të gjithë, por nuk janë të lirë, nuk kanë as vetet e tyre. Atdheu duket i mbyllur forcërisht... si një teatër absurd, ku të zihet fryma e ti je i detyruar të shohësh të njëjtën skenë, të njëjtën komedi. Që vetëm duke u bërë aktor mund të përballohet. Xhaxhai më fliste për ndryshime të mëdha, punohen tokat kudo, bëhen ndërtime, rugë, shkolla, spitale, hidrocentrale, shpesh më dukej se donte t'ia thoshte vetes me zë, që ta dëgjonin të tjerë, dakord, s'isha kundër, doja t'u gëzohesha edhe unë, por mjaftonte të shikoja sytë e trishtuar të nënës time, atë buzëqeshje të venitur që të rrënoheshin të gjitha...".

As për lotin e një fëmije

Diçka të ngjashme më tha edhe një koleg rus. Në mesin e viteve të 90-ta të shekul-

lit të kaluar kur po punoja në Departamentin e Kimisë në Universitetin e Idahos, në grupin e profesorit me të cilin punoja erdhi një koleg rus nga Universiteti i Moskës. (Për kurreshtjen e lexuesit, edhe qyteti ku ndodhej universiteti quhej Moscoë – Moskë. Dhe këtë bashkëpunim e quanin: nga Moskë në Moskë.). Ai ishte një djalë i qetë dhe me të bisedoja edhe rusisht, sepse anglishtja e tij nuk ishte aq e mirë. Bisedonim shpesh edhe për gjendjen në Rusi, vitet e sistemit sovjetik, etj. Më interesonte të dija se çfarë qëndrimi kishte për sistemin komunist të ish-Bashkimit Sovjetik dhe si do ta karakterizonte atë periudhë. Nuk doja ta pyesja në mënyrë direkte për të mos e vënë në ndonjë pozitë të pakëndshme apo provokuese, prandaj provova pak më ndryshe, në një mënyrë të tërthortë dhe iu drejtova: Trofim, po Bashkimi Sovjetik ka arritur edhe sukseset, ndërsa ai menjëherë m'u përgjigj: Sadik, nuk ia vlen as për lotin e një fëmije. Kështu, fare qart e në një mënyrë mjaft domethënëse më tha një koleg rus që ai vetë, babai i tij, e me siguri edhe gjyshi i tij ishin lindur e rritur në vendlindjen e bolshevizmit. E në Shqipëri sa lot janë derdhur, sa gjak është derdhur, sa jetëra njerëzish e familje janë shkatërruar, sa njerëzve të pafajshëm as varri ende nuk u dihet! E dikush ende sot e mbiron atë regjim se paskan bërë këtë e atë. Të gjitha kanë mundur të bëhen pa shkatërrimin, terrorizmin e një populli të tërë (përveç atyre të privilegjuarëve të atij regjimi). Diku në një shkrim lexova

edhe një thënie të ngjashme nga F. M. Dostojevski (1821 – 1881): "Madje as lumturia më e madhe e botës nuk do t'ia vlenë çmimin e një loti në faqet e një fëmije të pafajshëm".

Shembuj të guximit intelektual

Ndoshta mund të kuptohet heshtja në kohën e diktaturës, sepse për një fjalë goje rrezikohej jeta, familja, madje edhe farefisi i gjërë. Por, sot në liri e demokraci ende të mbrohen krimet e komunizmit?! Edhe gjatë diktaturës ka patur mjaft njerëz të guximshëm që e kundërshtuan diktaturën dhe vetë diktatorin, duke e fluar edhe jetën e tyre. Të kujtojmë shkencëtaren e parë shqiptare, Sebiha Kasimati, që me mjaft guxim u ballafaqua me diktatorin: "Kam ardhur të të them se ti po vret gjithë intelektualët. Dua të të pyes se, me cilët ke ndërmend ta ndërtosh Shqipërinë, me teneqexhinjtë apo me kepuçetarët?!" Dihet fati tragjik i Sebiha kasimati – u pushkatua në vitin 1951. "Po të më jepni një top, do të qëlloja mbi regjimin tuaj" – ishin fjalët e fundit të poetit të talentuar e atdhetar, Trifon Xhaxhika, para trupit gjykues, inkuizitorëve të tij. Edhe Trifoni u pushkatua në vitin 1963, në moshën 31 vjeçare.

Historia e shtrembëruar nuk mund të jetë mësuere e mirë

Gjatë historisë së tyre shumë gjëra të tmerrshme, çnjerëzore u kanë ndodhur edhe disa popujve e vendeve të qytetëru-

ara e të përparuara. Të kujtojmë këtu Gjermaninë Nacistë e Italinë Fashiste. Por, këto vende janë ballafaquar me të kaluarën e tyre, i kanë pranuar, dënuar e gjykuar gabimet, krimet e tyre të tmerrshme. E kanë hequr atë gur të rëndë nga qafa e ndërgjegjes së tyre kombëtare dhe sot Gjermania e Italia janë bërë forca motorike e zhvillimit demokratik e ekonomik të Bashkimit Europian. Po në Shqipëri? Ende nuk janë pranuar e dënuar krimet e komunizmit në mënyrë institucionale e shtetërore. Ende paraqiten në publik simbolet e komunizmit. Disa historianë tanë në vend se të merren me studimin e asja periudhe, t'i analizojnë me vërtetësi e saktësi shkencore ato ngjarje, ata nëpër studio televizive e mbrojnë atë regjim. Akademikët rumunë e kanë bërë një studim kritik për regjimin komunist në vendin e tyre. Gjërta studiohen me një sy kritik e me gjykime të shëndosha, që të mos përsëriten më. Nga historianët e deridjeshëm, vegla të regjimit të kaluar, nuk mund të pritet një studim historik objektiv. Madje edhe vetë Ramiz Alia, udhëheqësi i fundit komunist e tha në një intervistë se nuk mund ta rishkruajnë historinë ata që vetë e kanë shkruar me parë. Na duhen studiues të rinj të përgatitur nëpër universitetet përendimore e të liruar nga çdo bagazh i së kaluarës. Derisa të mos dënohen krimet e komunizmit do të jemi një popull me ndërgjegje të vrrarë dhe kjo gjithmonë do të jetë një pengesë për të ecur përpara. Historia e shtrembëruar kurrë nuk mund të jetë mësuere e mirë e jetës.

Philadelphia, më 10 qershor 2024

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Dotech
website 

Akoma nuk jeni
regjistruar
në Google?

NA KONTAKONI

Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT



Vendoseni
biznesin tuaj
ne rrjetin e
bizneseve ne UK

020 7018 7929

Mob: 073 4066 5946

Mob: 078 5997 7545

ISMAILI IKU, NE NA MBETET KADAREJA

ANDI BUSHATI

Ikja nga kjo botë e Ismail Kadarese do të provojë, ndofta për të kush e di sa të disatën herë, se fundi i përditshmërisë së jetës reale është sakrificë e detyrueshme që shkrimtarët e mëdhej të hyjnë në panteonin e zgjedhur të një kombi. Çlirimi nga pesha e trupit, fundi i takimit për kafe me njerëz të zakonshëm, lënia pas e obligimit për të reaguar për gjëra nganjëherë të vogla, i shpëton ata nga një mallkim i pashmangshëm, gjykimi i bashkëkohësve.

Kështu ka ndodhur edhe me Ismailin. Madje në dy kohë. Në atë të regjimit të Enver Hoxhës, ku ndonëse i shpëtuar disa hetë nga vetë lideri komunist, ai mbeti shkrimtari i dyshuar, i survejuari nga sigurimi, shkrimtari shpezh i ndaluar, njeriu që arriti të shpëtojë lëkurën vetëm se ngriti me “Dimrin e madh”, të vetmin portret të udhëheqësit që arriti të fitojë famë dhe në perëndim.

Në periudhën tjetër, atë post komuniste, ky u konsiderua mëkati i tij. Shumëkush nuk i fali as “Dimrin...”. as “Shqiponjat fluturojnë lart”, as të qenit deputet, as pranimin e postit të numrit 2 pas Nexhmije Hoxhës, e aq më pak përdorimin e organeve të represionit për zgjidhjen e hallevë të veta familjare.

Sa ishte gjallë, Ismaili ka qenë gjithnjë në mes, ose i adhuruar ose i anatemuar. I detyrueshëm për të mësuar përmendësh nga nxënësit e shkollave, për talentin me të cilin i thurte vargje partisë, por i parë me frikë nga aparatçikët dhe censorët, për dykupti-



mësinë e veprës së tij. I duartrokur nga disa, kur lexohej “Përse mendohen këto male” dhe i parë me shpresë nga të tjerë për zbrëthimin që i bënte tek “Pallati i ëndrave”, aparatit kafkian të Komitetit Qëndror. Për të parët që thjeshtë rripi më i talentuar i transmissiionit të propagandës së regjimit, për të dytët i vetmi që arrinte të zbrëthente publikisht absurditetin e tij.

Si student i letërsisë në vitet '80 e mbaj mend se si prisnim ti lexonim me lupë gjithçka të re që nxirrte nga dora, për ta parë alegorinë, kritikën, atë që s'guxonte ta bënte askush tjetër. Për ne, në atë kohë, ai ngjante si një rreze shprese, si i vetmi vegim i një bote më perendimore dhe disi më të lirë. Por ama nga ana tjetër sot i kuptoj të gjithë kritikët e tij që nga pozita idealiste i kërkojnë se mund të kish bërë shumë më tepër. Qoftë edhe

pa u rebeluar, të paktën të heshte me përbuzje si Lasgushi.

Kjo kontradiktë e shoqëroi fort Ismailin në tre dekadat e fundit të jetës së tij. Ai vetë, si njeri, bëri gabimin e madh se tentoi fillimisht të justifikohet para turmave. Arriti deri sa të pretendonte se me “Dimrin e madh” i kishte orfuar një maske diktatorit me shpresën se ky do të zbutej duke i ngjarë personazhit letrar të romanit. Me

dy esetë e para që shkroi në vitin '91, nga egzili parizian, u mundua ti veshë vetes rolin e një kundërshtari të regjimit që nuk mund të përtypej kollaj.

Vetëm vite më pas, kur i gjendur në një nga fortunat e zakonshme që ngriheshin kundër tij, vendosi të japë një intervistë në “Opinion”, foli troç: “Nuk kam qene kurrë disident” tha duke shtuar me arrogancën e dikujt që ka sigurinë e talentit të vet: “nuk jam i detyruar ti jap llogari shitësit të lagjes për veprat e mia, ato janë aty...le ti lexojnë”.

Kjo që linja përfundimtare që mbajti në daljet publike deri sa këto tre katër vite vendosi të heshtë, pothuajse plotësisht, sikur po përgatiste, që në të gjallë, kohën e vet të përjetësisë.

Sot, në 1 korrik dhe adhuresit edhe kritikët e tij, mësuam se Ismaili iku. Ne të gjithëve bashkë tani na mbetet Kadareja. Jo personi, por shkrimtari. Jo aktiviteti njerëzor, por vepra. Ajo e talentit padiskutueshmërisht më të madh që ka pasur gjuha e shkruar shqipe. Ajo e shkrimtarit me më shumë çmime dhe botime ndërkombe-tare. Ajo e magnisë së “Kronikë në gur”. Ajo e zejtarit që na ka lënë trashëgim sa e sa neologjizma të shqipes.

Nga sot e tutje këto do të jenë të vetmet njësi matëse për Kadarenë. Ashtu siç Sartri nuk mbahet mend për numrin vizitave në Moskë, apo Gabriel Garsia Markezi për takimet e pafundme me Fidel Kastron edhe nga Kadareja do të mbetet esencialja: letërsia e tij. Duke thënë lamtumirë, paradoksalisht, ai e lehtësoi këtë proces./Lapsi.al/



NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

Aleatët e NATO-s mbledhen në Uashington për një takim të nivelit të lartë që mbahet prej datës 9 deri më 11 korrik.

Perspektiva e rikthimit në pushtet, të Donald Trumpit, kritikut më të madh të aleancës ushtarake, po dominon diskutimes në mesin e aleatëve.

NATO – e përbërë nga 32 vende evropiane dhe të Amerikës së Veriut, të angazhuar për të mbrojtur njëritjetrin nga sulmet e armatosura – do të theksojë forcën përmes solidaritetit, ndërsa feston 75 vjetorin e themelimit të saj, gjatë takimit që fillon të martën. Joe Biden, i cili ai doli të tërheqë aleatët në një rrjet global për të ndihmuar Ukrainën të luftojë agresionin rus, e ka quajtur aleancën, më të unifikuar se kurrë ndonjëherë.

Por në prapaskenë, një temë dominuese do të jetë përgatitja për ndarje të mundshme, në kushtet e një rritje të partive të së djathtës ekstreme, jo miqësore me NATO-n, si në SHBA ashtu edhe vende të tjera, përfshirë Francën. Një gjë e tillë ka ngritur shqetësime rreth asaj se sa e fortë do të jetë mbështetja për aleancën dhe ndihma ushtarake që vendet anëtare të NATO-s dërgojnë në Ukrainë.

Gjatë debatit të parë presidencial zoti Biden pyeti zotin Trump nëse do të qëndronte në NATO apo do të tërhiqej prej saj. Përgjigja e zotit Trump ishte me gjeste që krijojnë paqartësi apo indifferencë.

Paraqitja e dobët e presidenti Biden gjatë debatit shkaktoi shqetësime dhe pikëpyetje të shumta nëse 81-vjeçari është i aftë për postin apo duhet të tërhiqet nga gara presidenciale.

Edhe përpara debatit, qeveritë evropiane kanë qenë në konsultime të vazhdueshme se çfarë mund të bëjnë për të siguruar që NATO, mbështetja perëndimore për Ukrainën si dhe siguria për çdo vend individual të aleancës, të mbijetojnë, edhe nëse zoti Trump fiton zgjedhjet e nëntorit.

Po kështu po zhvillohen diskutime për një reduktim potencial të kontributit amerikan ndaj aleancës.

Disa amerikanë dhe evropianë e kanë quajtur këtë përpjekje si “një NATO e

SHQETËSIMET MBI REZULTATIN E ZGJEDHJEVE NË SHBA, EVROPIANËT PO KËRKOJNË TË MBROJNË NATO-N



padepërtueshme nga Trumpi” ose “nga e ardhmja” kur bëhet fjalë mbi ndikimin tek aleanca, të një rritje të blloqeve të tjera politike të ekstremit të djathtë në Evropë.

Takimi i kësaj jave, që mbahet në qytetin ku u themelua aleanca e mbrojtjes së ndërsjellë në vitin 1949, pritej të ishte një festë mbi qëndrueshmërinë e NATO-s. Tashmë, tha një zyrtar evropian, kjo perspektive duket “e zyrtë”.

Dhe për këtë ka dy arsye: përparimi i Ruisë në fushën e betejës në muajt kur republikanët në Kongres, aleatë të zotit Trump, vonuan frunizimin me armë dhe financimin amerikan për Ukrainën si dhe mundësia e ardhjes në pushtet të qeverive të ekstremit të djathtë, jo miqësore me NATO-n.

Zyrtari foli me gazetarët javën e kaluar në kushte anonimiteti. Rachel Rizzo, një anëtare e lartë e institutit jopartiak të Këshillit Atlantik jep se një mesazh të prerë për evropianët: “frika nga një mandat i dytë i Trumpit nuk ndihmon askënd”.

Për aleatët në takim, tha ajo, çelësi do të jetë rezistimi ndaj tundimit për t'u ndaluar në detajet e ngjarjeve të pa-

precedenta në politikën e SHBA-së dhe për të ulur kokën në raport me përgatitjet e ndihmës ushtarake perëndimore për Ukrainën apo për një reduktim të mbështetjes së SHBA-së. Zoti Trump, i cili si para ashtu edhe pas presidencës së tij ka folur me admirim për presidentin rus Vladimir Putin dhe ashpër për NATO-n, shpesh i përqendron ankesat e tij tek kostot e aleancës dhe asaj që paguan SHBA-ja.

Rënia e Bashkimit Sovjetik në vitin 1991 e shtyu Perëndimin të mendonte se kërcënimin rus ishte neutralizuar, duke çuar në shkurtime të shpenzimeve ushtarake. Tashmë aleatët e NATO-s po forcojnë trupat e tyre kundër çdo agresioni më të gjerë nga zoti Putin dhe një numër rekord vendesh të NATO-s, 23 të tilla, po përmbushin objektivat e shpenzimeve për mbrojtjen.

Ish-këshilltari i zotit Trump për sigurinë kombëtare John Bolton, tha se ish-presidenti, në një mandat të dytë do të punonte për ta nxjerrë SHBA-në nga NATO. Kongresi miratoi një ligj vitin e kaluar, duke e bërë këtë gjë më të vështirë, por një president thjesht

mund të ndalë bashkëpunimin me disa ose të gjitha misionet e NATO-s.

Zgjedhjet në Francë, gjithashtu, duket se do të sjellin në fuqi më të madhe të partisë të së djathtës ekstreme kundër NATO-s nën udhëheqjen e Marine Le Pen. Forcat e ekstremit të djathtë po fitojnë terren edhe në Gjermani.

Disa zyrtarë dhe analistë evropianë thonë se kjo është thjesht tregues i rënies së besnikërisë së votuesve tek demokracia, me të cilën NATO është përballur edhe më parë.

Ata marrin si shembull Poloninë, ku një parti e krahut të djathtë humbi pushtetin vitin e kaluar dhe mbështetësit e saj kishin qenë ndër mbështetësit më të zjarrtë të NATO-s. Ata theksojnë gjithashtu rastin e Italisë, ku kryeministria populiste e krahut të djathtë Giorgia Meloni ka fituar vlerësime si aleate.

Evropianët thonë se duan të “institucionalizojnë” mbështetjen për Ukrainën brenda NATO-s, duke reduktuar varësinë nga SHBA-të.

Aleatët evropianë gjithashtu nuk arritën të merrnin armë të mjaftueshme për Ukrainën gjatë vonesës në një paketë ndihme të huaj të SHBA-ve, pranoi Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në largim Jens Stoltenberg në një vizitë në Uashington muajin e kaluar.

Kjo është “një nga arsyet pse unë besoj se ne duhet të kemi një rol më të fortë në NATO”, u tha zoti Stoltenberg gazetarëve.

Një iniciativë që ka të ngjarë të mbështetet në takim është që NATO të marrë më shumë përgjegjësi për koordinimin e trajnimit dhe ndihmës ushtarake dhe financiare për forcat e Ukrainës, në vend të SHBA-së. Evropianët po flasin gjithashtu për t'u dhënë ukrainasve një prani më të madhe brenda organeve të NATO-s,

megjithëse nuk ka ende konsensus për Ukrainën t'i bashkohet aleancës.

Evropianët thonë se vendet e NATO-s po koordinojnë deklaratat për Ukrainën për të bërë të qartë, për shembull, se një përshkallëzim tjetër nga Rusia do të përballlej me sanksione dhe ndëshkime të tjera të forta nga Perëndimi, dhe kjo edhe nëse SHBA-të nën një administratë të re Trump, nuk do të vepronin.

Zyrtarët e fushatës së zotit Trump nuk iu përgjigj menjëherë një emaili për komente.

Mundësia e një partneri me më pak varësi të SHBA-ja nën zotin Trump si president, po nxiti diskutime për një rol më të madh të evropianëve në programin e NATO-s për parandalimin e rrezikut bërthamor, sipas Qendrës për Studime mbi Sigurinë me bazë në Poloni. SHBA-të aktualisht luajnë rol përcaktues në armët bërthamore të vendosura në Evropë.

Por vendet evropiane dhe Kanadaja, me buxhetet dhe ekonomitë e tyre më të vogla ushtarake, janë vite larg përmbushjes së çdo boshllëku të madh të NATO-s që mund të krijonte SHBA-ja.

“Nëse një president amerikan vjen në detyrë dhe thotë: kemi mbaruar punë me këta (NATO-n), dotë këtë patjetër vullnet në Evropë për të plotësuar rolin amerikan”, tha John Deni, një bashkëpunëtor i lartë për sigurinë në Këshillin Atlantik. “Britanikët do ta merrnin përsipër këtë gjë”.

Por “edhe ata do të pranojnë se nuk kanë kapacitetin apo aftësinë dhe nuk mund ta bëjnë atë me shpejtësinë dhe shkallën që munden SHBA-të”, shton ai.

“Koncepti se ne po e bëjmë NATO-n të padepërtueshme nga Trumpi apo nga zhvillimet në të ardhmen, mendoj se kjo është kryesisht fantazi”. / Zëri i Amerikës

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

E nesërmja fillon tani!

Dotech
websites 

Jepi frymëmarrje biznesit tuaj!


Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT

Për çdo konsultim mund te vini
në çdo kohë në zyrat tona

Dotech
websites 


Na kontaktoni:
020 7018 7929

Mob:073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



**FOR
SALE**

**Barbershop for sale near
Old Street station London N 1**



Barbershop For Sale

Good selling price

**Long establish business
since 1967 reason for
selling Owner retiring**

Contact Us

07305 74 0907

**Cheap rent
Easy renewable lease**



REASONABLE PRICE



REASONABLE PRICE



07913 693801

Contact John evening after 7 30 pm

EMIN AZEMI

LETËRSIA E KADARESË ZGJEROI “MUSHKËRITË” E GJUHËS SHQIPE NË FRYMËMARRJEN E KOMUNIKIMIT TONË KULTUROR

(Në vend të homazhit)

Shkrimtari Ismail Kadare është trajtuar dhe do të trajtohet nga shumë aspekte, por sipas mendimit tim, janë tre aspekte që e karakterizojnë individualitetin e tij krijues.

E para, ai bashkë me një brez shkrimtarësh (Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Vehbi Skënderi, Risto Siliqi etj.) do të mbetet në historinë e letërsisë shqipe si shkrimtar që i priu thyerjes së kli-sheve të të shkruarit, si në poezi, ashtu edhe në prozë. Realizmi socialist i ngjante një djerrine të tharë dhe të pagjak, por Ismail Kadare ishte një oazë e gjelbër, plot me freski dhe jetë në atë shkretëtirë, që ia ndryshoi përgjithësisht imazhin letërsisë shqipe brenda dhe jashtë. Falë kësaj oaze, shumë shkrimtarë të tjerë, sidomos në Kosovë, zhvilluan talentin e tyre duke patur si referencë letërsinë e Kadaresë.

E dyta, Ismail Kadare, bashkë Martin Camaj, është “karikuesi” më i fuqishëm i letërsisë me elegancën fjalëformuese të gjuhës shqipe dhe me shtresat shumëkuptime-idiomatike të saj. Janë bërë përpjekje që të përpilohen fjalorë të ndryshëm dhe studime të shumta nga ky kontribut madhor i Kadaresë, por është shumë pak në krahasim me rëndësinë që ka letërsia e Kadaresë në zgjerimin e “mushkërive” të gjuhës shqipe në frymëmarrjen e komunikimit tonë kulturor.


E treta, askush si Ismail Kadare nuk e afirmoi më mire në botë vertikalen shpirtërore të shqiptarëve. Veprat e tij të përkthyer në mbi 40 gjuhë, artikuloan dhe argumentuan qenësinë e një kombi, të cilin shpesh e politikës e kishin lënë në margjinë. Vetëm pasi u

lexua vepra e tij, bota i njohu më mire shqiptarët dhe e kuptoi më qartë fatin e këtij kombi të ndarë si mos më keq. Për rrjedhojë, Kadareja edhe personalisht në komunikim me burrshtetasit e botës (me George Bush plakun, Jacques Chirac etj) kishte vënë në dispozicion autoritetin e tij në favor të kauzës së Kosovës, duke dhënë alarmin se regjimi serb po i vërsulej për ta asgjësuar njërin prej popujve më të lashtë të kontinentit evropian.

“Do të dëshiroja vetëm që të tërheq edhe një herë vëmendjen tuaj, Zoti President, për popullin me fatin më tragjik, të krejt kontinentit evropian: shqiptarët.

Ky është i vetmi popull në historinë e Europës, që pas dy mijë vjetëve jetë u nda më dysh, që në fillim të shekullit të XX-të prej Fuqive të Mëdha.

Ky është i vetmi komb, që në këtë shekull u shtyp prej dy diktaturave më të egra, që ka njohur bota: diktaturës së komunistëve shqiptarë dhe diktaturës së komunistëve serbë.



Ky gjytmim e kjo shtypje dyfishe, e ka lodhur dhe e ka dëmtuar rëndë këtë komb. Tani, gjysma e tij, ajo që jeton brenda kufijve të shtetit shqiptar, është duke e fituar më në fund lirinë. Por gjysma tjetër, ajo që ende ndodhet nën komunistët serbë, është në zi dhe në mjerim. Zoti Presidenti SHBA! Mendoj se është e palejueshme dhe në kundërshtim me të gjitha ligjet e natyrës, të së drejtës universale dhe të

Zotit, që ky komb të vazhdojë e të jetë i dënuar kështu.

Dhurata që iu bë terroristëve serbë që vranë më 1914 në Sarajevë, dukën Ferdinand të Austro-Hungarisë, duke u dhënë si shpërblim gjysmën e Shqipërisë, është një nga krimet më të rënda në historinë e njerëzimit. Sa më shpejt që bota e qytetëruar ta çlirojë veten e saj nga ky krim, aq më mirë do të jetë”, i shkruante Kadare më 11

shtator 1991, Presidentit të atëherëshëm të SHBA, George Bush.

Shatë vjet më vonë, kur soldateska serbe po bënte kërdi në Kosovë, Ismail Kadare i drejtohet sërish me letër, një presidenti tjetër.

“Në sytë e Europës e të Perëndimit të krishterë, qytetërimi i të cilit, bazohet sot më tepër se kurrë mbi vlerat e lirisë e të drejtave të njeriut e të popujve, po kryhet një krim me përmasa të padurueshme. Një shtet i egër stalinist, po djeg e po rrënon fshatra e qytete, vret gra e fëmijë, shpërngul me dhunë qindra e mijëra njerëz e kryen spastrim etnik, pa u ndëshkuar prej askujt.

Cili shtet në Europë do të guxonte të masakronte me tanke, helikopterë dhe flakëdhëse shtetasit e vet?... Kjo, që po ndodh sot në Kosovë, nuk është as rastësi dhe as surprizë.

Ky krim është përgatitur prej kohësh, dhe Europa dhe SHBA, janë paralajmëruar me kohë për të. Megjithatë veshi është bërë i shurdhër...”, i shkruante Kadare (më 26 gusht 1998), mes tjerash, Presidentit të atëherëshëm francez, Jacques Chirac.

Tani kur Kadare na mbetet në mendje vetëmi si imazh, si kujtim, emri dhe vepra që la pas do të jenë edhe një peng për ndërgjegjen tonë në formë detyrimi ndaj vlerave që la ai trashëgim, duke i ranguar ato në rrafshin më sipëror të mbamendjes sonë kolektive.



**NA GJENI NA FACEBOOK
KERKO THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES**

**POROSISNI BANNERIN
PËR BIZNESIN TUAJ**

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dottech
website

KLODIAN RADO

Ndërsa Shqipëria përga titet për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, një çështje thelbësore që kërkon vëmendje të veçantë jo vetëm nga politika, por sidomos nga publiku i gjerë është legjitimiteti kushtetues i këtyre zgjedhjeve pa përfshirjen e diasporës shqiptare. Thënë më shkurt: A mund të zhvillohen zgjedhjet e 2025 pa diasporën, dhe cilat do të ishin pasojat, nëse do të ndodhte? Më poshtë do të rendis një sërë argumentesh kushtetuese/ligjore dhe jo vetëm, se përse kryerja e zgjedhjeve parlamentare pa votën e diasporës nuk mund të jetë më një opsion, pasi do të ishin juridikisht të pavlefshme, pra “nul”.

E drejta e diasporës për të votuar, si detyrim kushtetues i shtetit shqiptar: Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, me Vendimin Nr. 38/22, vendosi në mënyrë të prerë: “Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve në zgjedhjet për Kuvendin, për shkak të boshllëkut ligjor. Detyrimin e Kuvendit për plotësimin e boshllëkut ligjor brenda një viti”, pra deri në datën 9 janar 2024. Kështu, Gjykata Kushtetuese urdhëroi qartazi Kuvendin që të amendojë Kodin Zgjedhor, duke miratuar dispozita ligjore që i garantojnë çdo votuesi që ndodhet jashtë Shqipërisë të marrë pjesë në procesin zgjedhor për zgjedhjet parlamentare të ardhshme dhe kërkoj që ky proces të jetë sa më i shpejtë dhe sa më efektiv. E thënë më thjeshtë, vendimi i Gjykatës Kushtetuese qartëson se diaspora ka të drejtën të votojë nga jashtë Shqipërisë dhe është detyrim i shtetit shqiptar të garantojë këtë të drejtë. Sipas Gjykatës, Kodi Zgjedhor në gjendjen aktuale nuk garanton të drejtën e diasporës për të votuar nga jashtë Shqipërisë dhe si i tillë, është antikushtetues për shkak të mungesës së dispozitave ligjore, që garantojnë të drejtën e tyre të votës. Ky vendim është vërtetë një akt historik për diasporën dhe për të drejtën kushtetuese të votës në Shqipëri, pasi ndodh për here të parë në historinë e shtetit shqiptar. Megjithatë, edhe pse kanë kaluar mbi 6 muaj që kur afati kushtetues i lënë nga Gjykata Kushtetuese ka skaduar, ende nuk është ekzekutuar. Quo vadis Shqipëria në zgjedhjet e ardhshme?

Neni 45 i Kushtetutës garanton të drejtën e votës për të gjithë qytetarët, pavarësisht vendbanimit të tyre. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, vota e diasporës nuk është më thjesht një e drejtë abstrakte teorike e mbetur në letër. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, që nga janari i vitit 2023, përjashtimi i diasporës nga votimi për zgjedhjet parlamentare dhe kryerja e tyre pa pjesëmarrjen e afro 2 milionë shqiptarëve që ndodhen jashtë Shqipërisë, nuk mund të jetë më një opsion. Nëse do të ndodhte, një proces i tillë zgjedhor do të ishte asgjë më pak se sa një proces zgjedhor antikushtetues dhe do të ishte një nulitet juridik, që nuk mund të sjellë asnjë

ZGJEDHJET PA DIASPORËN, ANTIKUSHTETUESE



pasojë juridike. E thënë ndryshe, deputetët e pretenduar si të zgjedhur, Kuvendi, qeveria që do të tentohej të votohej prej tij dhe çdo institucion tjetër që buron nga këto zgjedhje, do të ishin jolegjitime dhe të pavlefshme. Nuk është e nevojshme për të qenë jurist apo konstitucionalist për të kuptuar që një proces që përjashton nga e drejta për të votuar afro gjysmën e shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë, nuk mund të prodhoni asnjë institucion legjitim në Shqipëri.

Krijimi i precedentit ligjor të rrezikshëm dhe minimi i besimi publik: Moszbatimi ende i këtij vendimit të Gjykatës Kushtetuese nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë krijon një precedent të rrezikshëm për vetë ekzistencën e shtetit të së drejtës në Shqipëri. Nëse një institucion nuk zbaton vendimet e gjykatave, bash ai institucion ka filluar të mendojë të mos ketë më shtet. Një sjellje e tillë nga institucioni më i lartë ligjvënës, cenon parimin e shtetit të së drejtës sipas të cilit, askush nuk është mbi Kushtetutën, parimin e sundimit të ligjit dhe vetë autoritetin e Gjykatës më të lartë në vend, duke minuar besimin e publikut në institucionet shtetërore. Nëse vetë Parlamenti shqiptar nuk respekton shtetin e së drejtës dhe nuk zbaton vendimet e Gjykatës Kushtetuese, çfarë të presim nga institucionet e tjera më të ulëta, apo nga vetë qytetarët?

Parimi i drejtësisë dhe barazisë para ligjit: Përjashtimi i diasporës nga e drejta për të votuar është një mohim i drejtës së tyre themelore dhe bie ndesh me parimin e barazisë. Çdo qytetar shqiptar, pavarësisht vendndodhjes gjeografike në ditën e votimit, ka të drejtën të jetë i barabartë me bashkëkombësit e tij që ndodhen në Shqipëri dhe të ketë një zë të barabartë në qeverisjen e vendit të tij. Siç theksuam, zgjedhjet e mbajtura pa pjesëmarrjen e diasporës, janë thelbësisht të meta dhe si rrjedhim kushtetutshmërisht të pavlefshme, pasi lënë pa i dhënë mundësinë e votës pothuaj gjysmës së popullsisë shqiptare.

Cenimi i reputacionit të Shqipërisë në

arenën ndërkombëtare: Mohimi i së drejtës së votës për diasporën shqiptare ngre pikëpyetje të thella etike për përfshirjen dhe integritetin moral të sistemit zgjedhor të Shqipërisë dhe vetë organeve të qeverisjes. Shqipëria, si vend kandidati i BE-së, e ka detyrë respektimin e normave demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve. Mospërfshirja e diasporës në procesin zgjedhor rrezikon të dëmtojë rëndë imazhin e Shqipërisë dhe institucioneve të saj, në arenën ndërkombëtare. Mosveprimi për të kryer ndryshimet në Kodin Zgjedhor për përfshirjen e votuesve të diasporës, siç është urdhëruar nga Gjykata Kushtetuese, sfidon drejtpërdrejt shtetin e së drejtës dhe strukturën e sistemit ligjor të Shqipërisë. Kuvendi i duhet të veprojë me shpejtësi për të amenduar Kodin Zgjedhor, që mandej t'i hapet rruga KQZ-së për të miratuar aktet nënligjore të nevojshme për të mundësuar votimin e diasporës. Ndryshe nga sa mendojnë disa aktorë të politikës shqiptare, KQZ-ja nuk mund të kryejë nxjerrjen e akteve nënligjore, pa pasur dispozita të qarta në Kodin Zgjedhor, siç ia kërkon tashmë në mënyrë të detyrueshme Gjykata Kushtetuese. Kjo është detyrë kushtetuese e Kuvendit, të cilën nuk mund ta delegojë.

Fleksibiliteti teknologjik dhe përfshirja e diasporës: Forma klasike e votimit të diasporës është me postë dhe ky mund të jetë modeli më i pranueshëm në Shqipëri, për shkak të nivelit të lartë të mosbesimit. Përveç votimit me postë, një formë tjetër mund të jetë edhe votimi elektronik, duke ruajtur garancitë e mosprekjes të votës. Në epokën digjitale të sotme, sfidat logjistike të zbatimit të votimit të diasporës dhe siguria e saj mund të jenë të kapërcyeshme. Me planifikim të duhur dhe adoptimin e teknologjive të sigurta të votimit, Shqipëria mund të lehtësojë pjesëmarrjen e qytetarëve të saj jashtë vendit pa kompromentuar integritetin e zgjedhjeve. Megjithatë, kritikë e atyre që janë skeptikë duhet të merren seriozisht, që diasporës shqiptare t'i mundësohet një mënyrë

sa më e sigurt dhe e denjë votimi. Më e rëndësishmja është përfshirja e diasporës në procesin zgjedhor, duke dërguar një mesazh të fuqishëm uniteti kombëtar, dhe forcuar idenë që të gjithë shqiptarët, pavarësisht se ku jetojnë, janë anëtarë integrale të një etniteti.

Kontributet ekonomike dhe ruajtja e identitetit kombëtar: Diaspora shqiptare është një nga kontribuuesit më të mëdhenj në ekonominë e vendit përmes remitancave dhe investimeve. Mospërfshirja e tyre në votimet parlamentare dërgon një mesazh të gabuar se shqiptarët që jetojnë jashtë janë qytetarë të dorës së dytë për Shqipërinë, gjë që është e papranueshme jo vetëm juridikisht, por edhe moralisht e ekonomikisht, kur dihet që emigrantët përbëjnë ende zërin më të madh të ekonomisë shqiptare. Duke i përfshirë në procesin zgjedhor, shteti shqiptar njeh kontributet e diasporës dhe inkurajon më shumë angazhim në zhvillimin e kombit. Për më tepër, diaspora është një faktor i rëndësishëm social dhe kulturor, dhe mundësia e votimit për ta rrit interesimin dhe lidhjet e tyre me të forta me Shqipërinë, të cilat janë thelbësore për ruajtjen e identitetit dhe trashëgimisë kombëtare. Gjithashtu, është lehtësisht e kuptueshme që vendimet e qeverisë shqiptare nuk janë pa pasojë për diasporën shqiptare, kudo që ata jetojnë.

Rruga përpara, thirrje për veprim: Meqenëse juridikisht koha ka skaduar, tashmë po bien kambanat e alarmit, e ka ardhur ora për veprim. Kuvendi i Shqipërisë duhet të marrë masa të menjëhershme për të amenduar Kodin Zgjedhor, duke shtuar dispozitat ligjore dhe mekanizmat e nevojshëm ligjore për të lejuar votimin e diasporës. Ky jo vetëm që është një detyrim kushtetues i sanksionuar nga Gjykata Kushtetuese me vendim gjyqësor, por është edhe një test i pjekurisë së politikës shqiptare dhe angazhimit ndaj parimeve demokratike. Siç theksuam, hyrja në zgjedhje me Kodin Zgjedhor aktual, i shpallur antikushtetues për mungesën që ka ndaj votës së diasporës, do të

prodhonte zgjedhje antikushtetuese. Çdo jurist dhe jo vetëm e kupton që zgjedhjet e bazuara mbi një sistem zgjedhor antikushtetues janë automatikisht të pavlefshme dhe nuk mund të pasjellin efekte juridike. Prandaj, thirrja që i duhet bërë klasës politike është imperative, duke përdorur çdo mjet të nevojshëm demokratik.

Organizatet dhe liderët e diasporës duhen falënderuar për kontributin e deritanishëm, sepse ishte njëra prej tyre (Diaspora për Shqipërinë e Lirë), e cila e çoi dhe fitoi çështjen e votës në Gjykatën Kushtetuese. Gjithashtu, është kjo organizatë që krijoi grupin e punës së ekspertëve ligjorë të diasporës, duke bërë gati edhe projektligjin për ndryshimet e Kodit Zgjedhor bazuar mbi modelet më të mira të vendeve të zhvilluara, projektligji i cili iu vu në dispozicion Kuvendit, çdo deputeti, organizmave ndërkombëtare, KQZ-së etj.. Megjithatë, diaspora shqiptare dhe këto organizma përfaqësuese kurrsesi nuk duhet të vetëkënaqen. Ato duhet të vazhdojnë të avokojnë për të drejtat e tyre dhe të bashkëpunojnë me institucionet shqiptare dhe ndërkombëtare për të ndërtuar dhe zbatuar një sistem efikas votimi për qytetarët jashtë vendit. Ky bashkëpunim do të sigurojë që procesi të jetë sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

Zbatimi i metodave të sigurta të votimit (përmes postës tradicionale ose elektronike) mund të sigurojë që çdo shqiptar të ketë mundësinë të ushtrojë të drejtën e tij për të votuar pavarësisht vendndodhjes gjeografike. Zgjedhjet e parlamentare të vitit 2025 janë një mundësi e artë për Shqipërinë që të tregojë përkushtimin e saj ndaj demokracisë, respektimit të së drejtave themelore dhe shtetit të së drejtës.

Si qytetarë të Shqipërisë, në dimension personal, social apo institucional, ne duhet të bashkohemi dhe të mbështesim këtë kauzë. Afati kushtetues tashmë ka skaduar dhe ne duhet të kërkojmë me çdo mjet të mundshëm demokratik që Kuvendi të miratojë ndryshimet ligjore për votën e diasporës, si dhe të angazhohemi në dialog konstruktiv që zgjedhjet e vitit 2025 të jenë një reflektim i vërtetë i shpirtit shqiptar. Le të bëjmë që zgjedhjet e vitit 2025 të jenë një dëshmi e përkushtimit të Shqipërisë dhe të institucioneve të saj, duke treguar maturinë e një vendi që pretendon të behet anëtare e familjes së BE-së. Së bashku, ne mund ta kthejmë këtë moment sfide në një mundësi të rëndësishme të përparimit demokratik, duke vendosur një standard jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për demokracitë e reja kudo në botë. Ashtu u bëftë!

KUJDES KSAMILJOT, JO 200 EURO NJË NATË DHE 80 EURO NJË SHEZLONG!

ARBEN MANAJ

Shoh me shqetësim në mediat sociale, por edhe nga burimet e mia se në Ksamil, çmimet kanë kapur qiellin si 80 euro për një shezlong apo 200 euro për një natë, etj etj!

Kjo është çmenduri dhe mendjelehtësi që nisur nga historia e resorteve të tjera shqiptare që e kanë pësuar nga grykësia, ka vepruar si bumerang.

Praktika “u bë deti kos” është kundërproduktive dhe të jeni të sigurt se do shndërrohet në gropë për të ardhurat afatshkurtër për bizneset dhe banorët që bëjnë biznes në turizëm në atë që me apo pa të drejtë në mediat e huaja është quajtur “Maldivet e Evropës”!

Lexoj dhe dëgjoj edhe drejtpërdrejt nga anglezë që duan të shkojnë në Ksamil se këto çmime bien ndesh me raportet dhe shkrimet dashamirëse nëpër mediat ndërkombëtare dhe rrjetet sociale për lirëshmërinë e çmimeve në atë resort!

Çmimet mund të argumentohet se i vendos tregu! E qartë dhe e kuptoj, por kam frikë se kjo situatë do ç’bëjë reklamën e madhe për turizmin në përgjithësi në Shqipëri dhe Ksamilin në veçanti!

Kam frikë se Ksamil do e pësojë si Durrësi dikur dhe lipset të mësojë nga Durrësi apo Velipoja. Këtë shqetësim e kam edhe si shqiptar që ka një pronë në Ksamil.

Mos i largoni ata që ju mbajnë me bukë se nuk janë budallenj sepse kanë edhe opsione të tjera, qoftë edhe nëpër Shqipëri apo në shtetet afër.

Koha do i japë të drejtë edhe këtë sezon, por edhe më vonë kësaj çmendurie që s’ka se si quhet “low-cost Greece”!

Më pak grykësi dhe me shumë zgjuarsi bashkë-ksamiljot! Turizmi nëse nuk e dini ende, është shumë kapricoz. Sepse mund të mos ju vijnë më turistët më këto çmime të tmerrshme.

Mos qoftë ky fati i Ksamilit!



ZGJEDHJET NË BRITANI, LABURISTËT NUK U RRIJEN, KONSERVATORËT U RRËZUAN

Me “ndryshimin” si flamurin e tij dhe “rinisjen e madhe” të vendit të tij si prioritet, kryeministrit të ri britanik Keir Starmer iu dha mandati për të formuar një qeveri dje, duke shpallur ndryshimet që ai arriti në Partinë Laburiste si një shembull të ndryshimeve të përgjithshme. ai dëshiron të sjellë në Britani.

Me një ekip të freskët, të përbërë nga drejtues të gjeneratës së re dhe shumë gra, qeveria e re laburiste nuk fshehu shumë surpriza, por sigurisht disfatën elektorale të konservatorëve, të cilët humbën pushtetin pas 14 vitesh dhe me një pikë përqindje një stacion për Kriza e karakterit të ekzistencializmit, në të cilën tashmë është vendosur një nga partitë më historike në Evropë.

Nga ana e tij, Keir Starmer e përshkroi stabilitetin dhe moderimin si shtyllat e politikës së tij për të ecur përpara, duke njoftuar se laburistët “do të kishin një prani më delikate në jetën e njerëzve”, duke premtuar energji të lirë, infrastrukturë të re dhe vende të reja pune. Pikat kryesore të administratës së tij përfshijnë zgjedhjen e Rachel Reeves si Kancelare e Thesarit, duke u bërë gruaja e parë në historinë britanike që mban atë portofol. “Unë nuk kam asnjë iluzion për sfidat me të cilat përballlemi,” komentoi zonja Reeves, duke shtuar se ajo nuk mund të premtojë se do të jetë e lehtë ndërsa “ka një rrugë të gjatë për të bërë. Jemi një skuadër e re, është një fillim i ri, ndaj le t’i shkojmë punës”, theksoi ai. Gjithashtu, David Lammy merr postin e Sekretarit të Jashtëm, John Healy si Sekretar të Mbrojtjes, ndërsa Yvette Cooper bëhet sekretarja e ardhshme e Brendshme.

Vota e mosmiratimit



Në terma të numrave absolutë, megjithatë, sipas numërimit të votave të deritanishme, fitorja e laburistëve nuk ishte rezultat i rritjes së tyre elektorale, por më tepër shtypja e drejtpërdrejtë e konservatorëve, të cilët humbën më shumë mandate sesa laburistët fituan, duke intensifikuar kuptimin e votës ndëshkuese ndaj qeverisë në largim. Në veçanti, laburistët fituan 1.6% krahasuar me 2019, ndërsa konservatorët humbën 20%.

Vendet në detaje:

– Laburistët kanë fituar 412 mandate, 211 më shumë se zgjedhjet e kaluara,
– Konservatorët 120 dhe humbin 250 mandate në krahasim me zgjedhjet e kaluara.

– Liberal Demokratët 71 (në performancën e tyre më të mirë ndonjëherë në zgjedhje),

– 9 Partia Kombëtare Skoceze
– 7 Sinn Féin
– 6 të pavarur
– 5 DUP

– 4 Partia Reforme e Farage
– 4 të Gjellbërit
– 4 Plaid Cymru
– 2 Partia Socialiste e Punës
– dhe nga 1 vend partia Aleanca, partia Unioniste Ulster dhe partia Zëri Tradicionale Unioniste Pavarësisht rinovimit të diskutit të saj programor dhe ekipit drejtues, partia tani në pushtet në Britani nuk do të ishte në gjendje të kthehej në pushtet nëse partia konservatore, e cila tashmë po testohet nga grindjet e brendshme, nuk u shemb elektoralisht pas rezultatit zgjedhor. Humbja e 250 vendeve për konservatorët nga zgjedhjet e mëparshme i lejoi laburistët të kalonin relativisht shpejt pragun e 326 vendeve për të formuar një qeveri vetëqeverisëse, duke përshpejtuar “fajësimin” midis figurave të larta në qeverinë Sunak.

Zjarr miqësor gjen edhe kryeministrin britanik në largim Rishi Sunak, ndërkohë që të paktën 11 ish-ministra të tij kanë përjetuar refuzimin e plotë të elektoratit. Duke qëndruar jashtë Commons, ish-sekretari i mbrojtjes

Grant Shapps shpjegoi se “ne kemi shterur durimin e votuesve tradicionalë konservatorë me tendencën tonë për të krijuar një telenovelë të pafundme politike të grindjeve dhe ndarjeve, e cila është bërë gjithnjë e më këmbëngulëse”. “Sot, votuesit ishin njësoj si: “Nëse nuk mund të pajtoheni mes jush, atëherë ne nuk mund të biem dakord të votojmë për ju”. Ne kemi harruar një rregull themelor të politikës, që njerëzit të mos votojnë për parti të përçarë”, përfundoi ai.

Ndarja e brendshme e konservatorëve, por edhe gjashtë javët e fundit parazgjedhore, gjatë të cilave partia dërgoi mesazhe shpërbërjeje, sipas Politico, rezultoi në mos rizzgjedhjen e ish-kryeministres Liz Truss, e cila humbi rizzgjedhjen me 630 vota. Edhe për votuesit besnikë, konservatorët kanë harxhuar kapital të vlefshëm politik në luftime të brendshme, me një numër rekord skandalesh dhe dorëheqjesh gjatë pesë viteve të fundit, duke e bërë imazhin e partisë në disa raste të shëmtuar. Si rezultat, vetëm 33% e konservatorëve arritën

ta rizzgjedhin atë, me partinë që tani po hyn në trazira të thella brendpartiake. Pasiguri dhe dobësi menaxheriale Megjithatë, nuk ishte vetëm lufta e brendshme dhe fërkimi i vazhdueshëm midis konservatorëve kryesorë që e zmadhuan humbjen, por mbi të gjitha fakti që një nga partitë më të fuqishme në Evropë me traditë shekullore dha imazhin e një paaftësie të plotë për të menaxhuar të njëpasnjëshme. kriza, si Brexit, pandemia e koronavirusit, kriza e inflacionit, kreditë për banesa, por edhe përkeqësimi i sistemit shëndetësor publik, tërheqja shtet pas shtet në fushën e efikasitetit dhe sigurisë së qytetarëve. Pas një gjendje moribide qeverisjeje, zhgënjimi i votuesve përshpejtoi rënien e konservatorëve edhe në bastionet e tyre tradicionale, ndërkohë që sistemi zgjedhor i vendit luajti një rol vendimtar në formësimin e rezultatit, i cili si shumicë e kthen shumicën relative zgjedhore në shumicë absolute parlamentare, me si rezultat që në raundin e parë zgjidhet deputeti që merr shumicën relative.

Dobësitë sistematike

Kështu, në gjurmët e imta të rezultatit të ri të zgjedhjeve, vendet jashtëzakonisht të vlefshme nga konservatorët i kushtuan partisë Reforme të Farage, pasi ajo preu fillin e dytë në 103 nga 650 njësi zgjedhore, me tablonë përfundimtare që formohej me 35% të votave. sipas Euronews. Duke pasur parasysh dobësitë strukturore të sistemit zgjedhor të Britanisë, laburistët arritën të merrnin shumë vende, por jo një grup mjaftueshëm të madh votash, duke e bërë shumicën e tyre mjaft të brishtë, thonë analistët.



Akoma nuk keni Website?

PROFESSIONAL

AKOMA NUK JENI TË REGJISTRUAR NE GOOGLE?

ADRESA E ZYRAVE

30 AVENONS ROAD
LONDON E13 8HT



Responsive Website

Custom Website Design

Redesign Website

Web Development

Mobile App Design

E-commerce Solutions

KONTAKTONI



020 7018 7929



073 4066 5946

VETON SURROI

RIZBULIMI I KOSOVËS NË “CAFE LE ROSTAND”



1. Ismail Kadare filloi ta rizbulojë Kosovën në “Cafe Le Rostand” prej ditës kur arriti në Paris, së bashku me namin e njeriut që iku nga komunizmi në Shqipëri, rrëfimet e shënuara në kokë e që kërkonin lirinë e tyre në një copë letre tregimi, a novele, a romani dhe një ankh-gjendje pothuajse kronike - për një ardhmëri të jetës së tij, dukjes fizike, gatishmërisë mendore e shpirtërore që rrëfimet e ruajtura në kokë të dalin në letër ashtu siç e përcakton mjeshtëria e një zejtari të veçantë.

Një numër gjithnjë e më i madh shqiptarësh gjenin mënyra për t'u lajmëruar, me rekomandim të këtij apo atij, emra që zakonisht kishin domethënie për të e ndonjëherë kurrfarë dhe për shkrimtarin mjaftonte përmendja e prejardhjes kosovare-dicka që prekte te ai telin e ciklit të kreshnikëve dhe baladave të Veriut të Shqipërisë-që të pranonte e të caktonte takimin e radhës, mundësisht dikur pasdite, pas orës 18.

Zejtari Kadare e kishte të zënë gjithnjë dhe për çdo gjë mëngjesin deri në mesditë; dikur nga ora 10 i vinin në “Cafe Rostand” kreshnikët, rrugët e gurit, fermalet e dërguar nga Stambolli me vulën e fatit në të, balta e ngjitur në gomën e kamionit kinez që përpiqet t'i bëjë ballë moçalishtes për të arritur me kohë për ballon pranverore të punëtorëve më të dalluar, mes të cilëve edhe një bukuroshe me emër ende të pazbuluar. Që të gjithë ata kërkonin, me të drejtë, hapësirën e vet; të gjallë në botën e vet hynin ashtu te porta e Zeytarit, vetëm ishte punë e tij se si do të vazhdonin më tutje, ky ishte vendimi përfundimtar i atij që vendos për jetën e vdekjen, shkrimtari.

Në 12 merre vendimet e përkohshme-mërisë së veprave të pakryera, deri të nesërmen në të njëjtën kohë.

2.

Në orën 18 Zeytari merrej me një ëndërr sepse nuk do të qe e mundur të ishte realitet që t'i vinin folësit e ndryshëm dhe i tregonin për vendet e largëta shqiptare, për mjekë që bëhen politikanë, për poetë që bëhen ministra, për ministra që hapin dyqane, për të burgosur që do të sundojnë dhe për sundimtarë që do të bëhen të burgosur.

Ndër ta ishin të shumtë kosovarët. I vinin nga ëndërra e tij e vitit 1980 kur kishte qenë në Kosovë. Atje kishte parë godina më të mëdha se ç'kishte parë ndonjëherë në Shqipëri, rrugë më të rregulluara, njerëz më të veshur e vajza më të bukura. Familjet kishin televizorë me ngjyra dhe frigoriferë e megjithatë i ankohehin dhe kur i ankohehin flasin me të si me Nënë Shqipëri, e ai nuk ishte nënë. Mund të ishte ndoshta më shumë se kaq, ishte shqiptari dhe Shqipëria ashtu siç do ta donin atje në Kosovë - një të vargjeve mbi shiun, një të tri harqeve të urës,

një të okupatorëve që zakonisht mbledhin eshtrat e ushtarëve të vet në tokat arbërore, një e gjuhës e cila është aq e qëndisur sa ndonjëherë pyetesh se a është e mundur që ta ketë shkruar dora e njeriut dhe ku drejtin kishte qenë e fshehur për këta dymijë vjetët e kaluar. Në atë ëndërr Kadare shkante në Kosovë si njeri i kufizuar në liritë e tij pos në atë thelbësore, të të zbuluarit në kushte represioni artin e rrëfimit në gjuhën shqipe. Kosovarët e mirëprisnin, me ndjenjën se kishin më shumë liri se Kadare, përfshirë edhe atë të përdorimit të gjuhës shqipe, por nuk dinin si. Ky ishte mister i ruajtur mirë nga Zeytari.

Një Kosovë e tërë u rrit me Kadarenë; një gjysmë e saj krenare që gjuha shqipe kishte gjetur tregimtarin e saj, një gjysmë tjetër - gazetarë, shkrimtarë, mësues e profesorë, hulumtues shkencorë dhe joshkencorë- të dëshpëruar në heshtje të thellë se po e njëjta gjuhë, me po të njëjta shkronja, gramatikë e sintaksë nuk po mund të përshkruajë në të njëjtën formë atë që duan të përshkruajnë, apo atë që ende nuk dinë se çfarë duan të përshkruajnë.

Dhe Kadare filloi të rrisë dyshimin mbi veten e rolin e tij ndërsa i lajmëroheshin personazhe të ndryshme të ëndërrës së orës 18. I vinin për intervista, i sillnin libra për të nënshkruar, e lusnin për të dalë në fotografi me ato kamera Polaroid që nxjerrin foton menjëherë dhe për të cilat Ai kishte mendim negativ sapo t'i shihte - fotografitë duhet t'i ngjasonin atyre të disa viteve më parë, mundësisht atyre të kohës së studimeve, por me kokëfortësi refuzonin ta bënin.

Një ditë i erdhi njëri dhe i tha se Ismaili duhej të pronocohej për intelektualin më të madh të Kosovës e për të cilin ai nuk kishte dëgjuar ndonjëherë; e pranoi kërkesën, aq e madhe ishte Kosova e ëndërrave të tij sa me siguri në të do të ketë ekzistuar ai personazh për të cilin foli in extenso.

I erdhi një tjetër, personazh televiziv, i cili kur u kthye në Kosovë e përshkroi ngjarjen, i prituri nga miqtë e tij në një kafene, me meze e pije të

porositur nergut për këtë ngjarje.

-Ishim kështu, gu m'gu qysh jemi tash e i thashë: Smajl bre...

Ai m' tha: He!

Smajl bre, a bon me t' dvet dishka? He!

Çka po bohet me Kosovën, pashë at' - Zot?

Në atë moment bëhet pauza e rrëfimitarit, e mjaftueshme për të porositur raundin e ardhshëm të pijeve e mezes dhe për të shënuar heshtjen e fortë, të disiplinuar të të gjithë atyre që qenë bërë sy e vesh me respektin e thellë dhe pritishtërinë për fjalët që duhet të pasojnë si përgjigje.

-Ai vetëm tundi kokën, herë këndeje, herë andej, kishte një msheftësi në atë lëvizje, një msheftësi që nuk deshti ta ndante me mu.

Tundja e tij e kokës do të hyjë në rrëfim, odë pas ode, oxhak pas oxhaku, fshat pas fshati e dimër pas dimri - sa më i gjatë, aq më i mirë për rrëfim - dhe gjysma e rrëfimitarëve do të tregojnë se tundja e kokës ishte sinjali i Kadaresë se gjërat janë aq të koklavitura sa nuk ka kush t'i bjerë në fije e gjysma tjetër do të betohen se tundja e kokës ishte shenjë se Ismaili dinte se Kosova po hynte së shpejti në luftë, por këtë fjalë nuk mund ta nxirrte nga goja pa lot në sy e tashmë është e ditur se burrat nuk duan të shihen se si qajnë.

3.

Edhe unë u takova në “Cafe Le Rostand”, mund të ketë qenë edhe ndonjë kafe tjetër, por tashmë është bërë legjendë ajo “Rostand” e unë me këtë shkrim bëhem disi pjesë e asaj legjende, të çdo njërit prej nesh veç e veç e të gjithëve së bashku, që përpiqet të gjejë “msheftësitë”, ato që deshi apo nuk deshi t'i ndante me mua.

Në këtë rast ishin msheftësitë që deshi t'i ndante. U paraqit në kafe në orën e caktuar së bashku me Helenën, që të dy kuriozë ta takojnë një kosovar të ri për të cilin kishin dëgjuar të ishte pjesë e lëvizjes demokratike të fillimviteve nëntëdhjetë. U bënë edhe më kuriozë kur biseda vazhdoi nga Kosova në Shqipëri e nga puna e opozitës të zgjedhjet dhe te kandidati më i mirë për president dhe te konsta-

timi im se Shqipëria me president Ismail Kadarenë do t'i kishte dyert e hapura në botë, sepse më herët këto i kishte hapur një shkrimtar nga Shqipëria me të njëjtin emër e mbiemër.

Buzëqeshi me gjentilesën e një njeriu që e pranonte këtë si një kompliment. Buzëqeshi me befasinë e këndshme që i krijoi fillim mendor në të cilin e shihte veten, së bashku me Helenën, në kryeqytetet e mëdha të botës, me presidentë e mbretëresha e princër, duke mahnitur të pranishmit me fjalitë jokonvencionale të një shkrimtari, të marra nga thesari, herë në “Iliadë”, e herë të burimi për të i pashtershëm i Dantes, herë nga thëniet e Malësisë së Madhe. Dhe pas buzëqeshjeve erdhi qetësia e njeriut që tashmë e kishte menduar këtë gjë dhe kishte verdiktin më bindës e dramatikisht të sinqertë që kam dëgjuar ndonjëherë për të mos qenë i zgjedhur në një demokraci:

-Jam diktator. Jam shkrimtar dhe unë përcaktoj jetët e vdekjet në rrëfimet e mia; fjala ime bën dhe shkatërron botë.

Më tha “jam krijuesi” dhe nuk jam i sigurt në kishte menduar me “k” të vogël a të madhe.

4.

Sekretarja amerikane e shtetit Albright kërkoi ndihmën e Kadaresë. Në të vërtetë, kërkoi një autoritet moral shqiptar që ta bindte delegacionin e Kosovës në Rambouillet më 1999 se refuzimi i Marrëveshjes do të ishte gabim historik. Disa prej anëtarëve të delegacionit ishin të pabindur për këtë kthesë historike dhe diplomacia amerikane mendoi se një autoritet moral dikush që është i pakontestueshëm brenda kombit - ai që në shtete të tjera do të ishte një prijës fetar, një rektor universiteti apo një ish president - do të mund të bindte se në udhëkryqin mes të Mirës dhe të Keqes është mirë të përcaktohesh për rrugën e Perëndimit.

Kadare i shkroi një letër delegacionit. Nuk ishte Zeytari i orës 10 e as Pritësi ceremonial i rrëfimitarëve të ëndërrave të orës 18. Ishte ai që nuk ishte i lindur në Kosovë, por që ndiente se ajo ishte pjesë e tij sa ç'kishte parë që ai ishte bërë pjesë e saj.

Letra u lexua nga Rexhep Qosja njëri i cili shpesh kishte shprehur mospajtime publike me të, jo edhe gjithaq të kuptueshme si pjesë të një debati intelektual.

Një pjesë e anëtarëve të delegacionit e kuptuan këtë letër si një përpjekje fisnike e njeriut më të madh të letrave shqipe, një pjesë tjetër e anëtarëve si një përpjekje dëshpërimi sepse të gjitha format e tjera të të bindurit duket se dështuan, një pjesë tjetër shprehën respekt për letrën e Kadaresë dhe kërkuan të kalohet në pikën tjetër të rendit të ditës, një pjesë tjetër që

kishin ndërprerë komunikimin me letërsinë te “Lugjet e verdha” nuk komentuan publikisht, por pyetën njëritjetrit athua cili artist do të na lajmërohet pasdreke...

Delegacioni ende mbeti i padakorduar.

Në legjendë do të thuhet se Ismail Kadare bëri që shqiptarët e Kosovës ta përqafojnë Rambouillet.

Në histori do të hyjë fakti se duke kërkuar një autoritet moral ndër shqiptarët gjithandej kombit, diplomacia amerikane e gjeti shkrimtarin, atë që e kishte bërë gjuhën shqipe të kuptueshme për tërë botën.

5.

Një ditë në Qerret erdhi nga deti si dhuratë një peshk i zënë prej një peshkatarit gjeneroz. Gjysma e peshkut të madh ishte dhuratë për mua, gjysma për Ismailin.

Shkova ta dorëzoja dhuratën menjëherë, i vetëdijshëm se po hyja në zonën e orës 10 të mëngjesit, zonën ku Ismaili jeton me shtojzovallet, rrethin e radhës të Dantes, psenë e vërtetimit të përhershëm të Dostojevskit se Zoti ekziston, nevojën për disiplinë të hekurt të fjalisë e njëkohësisht të lirisë që fjala të vallëzojë e vetme në të po të dojë.

Shpresoja që do të hyja me diskrecion dhe t'ia dorëzoja Helenës. Ajo doli për një çast më vonë se ç'mendoja dhe Ismaili më pa me peshkun e kapur për bishti duke ardhur nga pylli, një skenë gjithsesi më afër zonës së tij të preferuar antike. Më ofroi që të ulesha për një çast se “edhe ashtu nuk e kam pirë kafenë para se ta filloj punën”. Në tavolinën e verandës, duke shikuar nga pylli dhe deti kishte dy fletore, njërin në të cilën shënonte mendime që i vinin dhe citate që i zbulonte a rizbulonte. Në tjetrën tashmë kishte filluar esenë e radhës.


Pas dhjetë minutash e lash, të gëzuar që po i rihynte punës, asaj në të cilën kishte gjetur formulën. Aty që ulur ende një student i letërsisë në Moskë, që kishte marrë sikur balerinat, baritonët e violionistët, më të mirat e teknikës së shprehjes - Gogol e Turgenjev, Tolstoj e Dostojevski, Lermontov e të tjerë të zbuluar pastaj - dhe i kishte ftuar që të ndërtojnë së bashku rrëfimin e shqiptarëve, një që si çdo rrëfim veç e veç e të gjitha së bashku janë sa lokale aq universale, për ta bërë atë rrëfim pjesë të pasurisë së civilizimit bashkëkohor.

6.

Kadare vdiq pa arritur zonën e orës 10. Do të jetë listë e gjatë e rrëfimeve që qenë duke pritur ta kalonin Portën e Mjeshtrit. Tash janë aty diku, duke pritur fatin e peshqve dhe rastësisë për t'u zënë.

NA KOTAKTONI

0 7947 785174



SHERBIME Te TONA

NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi
Per Shendetin
Tuaj

HAPUR
7 DIT
NE
JAVE

Numer Telefon
020 8341 3185

E-mail Address
Info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone
573 Green lanes, Harringay, London
N8 0RL

Oraret Sherbimet
te Henen. Shtunen:- 9 am - 7 pm
Te Dielen : 11 am- 6 pm



CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Pulse
- Temperature
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes (Sodium + Potassium + Chloride)
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose



Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Dotech
website 

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

**Ne mund t'iu
ndihmojme edhe me:**

Business Cards

Logos

Banners

Video Marketing

Adresa e zyrave

**30 Avenons Road
London E13 8HT**

